REPUBLIKA E SHQIPËRISË

USHTRIA

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E MBROJTJES

Viti i 82-të i botimit Nr. 44 (828000) | Botim Qendror i Ministrisë së Mbrojtjes | E premte, 6 nëntor 2026



SHQIPËRIA, NGA ANËTARE E NATO-s NË PARTNERE AKTIVE E SIGURISË KOLEKTIVE

» faqe 3



SHQIPËRIA FORCON BASHKËPUNIMIN RAJONAL NË KËRKIM-SHPËTIMIN AERONAUTIK

Zëvendësministrja e Mbrojtjes, Blerina Abrazhda, mori pjesë në takimin e dytë të Komitetit Këshillues Rajonal të Kërkim-Shpëtimit Aeronautik (RASARAC) për vitin 2026, organizuar nga Qendra Kombëtare e Kërkim-Shpëtimit (QKKSH). Takimi kishte në fokus forcimin e bashkëpunimit rajonal në fushën e kërkim-shpëtimit, koordinimin e operacioneve, vlerësimin e kapaciteteve dhe aseteve SAR...

faqe 4



PROF. DR. PROLETAR HASANI: HISTORIA USHTARAKE NUK ËSHTË VETËM KUJTESË E SË KALUARËS, POR NJË PËRGJEGJËSI PËR TË ARDHMEN

Kolonel në rezervë, historian ushtarak, pedagog dhe studiues, Prof. Dr. Proletar Hasani i përket atij brezi ushtarakësh që e kanë përjetuar ushtrinë në disa dimensione: në uniformë, në komandë, në auditor dhe në kërkimin shkencor. Për dekada me radhë, ai ka qenë pjesë e jetës së Forcave të Armatosura Shqiptare, duke nisur rrugëtimin si tankist e komandant dhe duke vijuar më pas në fushën...

faqe 6





NË BRUKSEL, MUZIKA U BË URË MES SHQIPTARËVE DHE MESAZHIT TË SHËN TEREZËS

Ansambli i Harqeve i Orkestrës Simfonike të Forcave të Armatosura, nën drejtimin e dirigjentit Fabjol Aliaj dhe me pjesëmarrjen e sopranos Markela Jakaj, solli në Kishën Notre-Dame de Laeken një mbrëmje të veçantë kushtuar Shën Terezës, në 10-vjetorin e shenjtërimit të saj. Zëvendësministrja e Mbrojtjes, Blerina Abrazhda, mori pjesë në takimin e dytë të Komitetit Këshillues...

faqe 9



SHQIPËRIA ORGANIZON KONFERENCËN E 33-TË TË KOMITETIT KËSHILLIMOR PRIMAR

IGJIU forcon bashkëpunimin ndërkombëtar në fushën e hidrografisë dhe të sigurisë së lundrimit detar



Instituti i Gjeografisë dhe Infrastrukturës Ushtarake (IGJIU), në kuadër të përfaqësimit institucional të Shqipërisë në Qendrën Rajonale Koordinuese të Produkteve Hartografike Detare PRIMAR, organizoi në Tiranë Konferencën e 33-të të Komitetit Këshillimor PRIMAR (PAC-33).

Aktiviteti treditor bëri bashkë 35 ekspertë dhe përfaqësues nga 15 shtete anëtare të PRIMAR-it, duke krijuar një platformë të rëndësishme diskutimi dhe bashkëpunimi në fushën e shërbimeve hidrografike, standardizimit të të dhënave dhe rritjes së sigurisë së lundrimit detar.

Gjatë konferencës, ekspertët shkëmbyen përvoja dhe pikëpamje mbi zhvillimin e shërbimeve hidrografike, përmirësimin e produkteve hartografike detare dhe harmonizimin e tyre me standardet ndërkombëtare. Ky bashkëpunim synon të forcojë ndërveprimin ndërmjet institucioneve përkatëse dhe të kontribuojë në ofrimin e produkteve e shërbimeve sa më cilësore për sigurinë detare.

Pjesëmarrja aktive e Shqipërisë në PRIMAR përbën një instrument të rëndësishëm për forcimin e bashkëpunimit ndërkombëtar, garantimin e cilësisë së produkteve hartografike detare të përgatitura nga IGJIU-ja, si dhe harmonizimin e tyre me standardet e Organizatave dhe Aleancave partnere.

Organizimi i PAC-33 në Tiranë dëshmon rolin aktiv të institucioneve shqiptare në strukturat bashkëpunuese ndërkombëtare dhe angazhimin e tyre për zhvillimin e kapaciteteve profesionale e teknike në fushën e hidrografisë dhe infrastrukturës detare.

Përmes këtij aktiviteti, IGJIU kontribuon në rritjen e profilit ndërkombëtar të Shqipërisë, në shkëmbimin e ekspertizës dhe në forcimin e standardeve që garantojnë sigurinë dhe besueshmërinë e lundrimit detar.

FORCA AJRORE, GATI PËR REAGIM NË EMERGJENCAT E KËRKIM-SHPËTIMIT

Helikopterët "Cougar" dhe "Black Hawk" në stërvitjen ndërinstitucionale "SAR-26"







Përgatitja, gatishmëria dhe bashkëveprimi janë elementë thelbësorë për përballimin me sukses të emergjencave reale. Në këtë kuadër, Forca Ajrore u angazhua në stërvitjen ndërinstitucionale të kërkim-shpëtimit "SAR-26", duke vënë në dispozicion kapacitetet e saj ajrore dhe ekipet e specializuara.
Në kuadër të stërvitjes, Forca Ajrore mori pjesë me helikopterët "Cougar" dhe "Black Hawk", duke kontribuar në testimin e procedurave të reagimit, vlerësimin e kapaciteteve kombëtare të kërkim-shpëtimit dhe forcimin e bashkëpunimit ndërinstitucional.
Angazhimi i mjeteve ajrore dhe efektivëve të Forcës Ajrore në këtë aktivitet synoi testimin në kushte sa më reale të gatishmërisë operacionale, koordinimit ndërmjet strukturave dhe aftësisë për të reaguar në kohë ndaj situatave emergjente.

Me kapacitetet e saj ajrore, përgatitjen profesionale dhe eksperiencën e efektivëve, Forca Ajrore mbetet një komponent kyç në operacionet e kërkim-shpëtimit, ku shpejtësia e reagimit, koordinimi dhe ndërhyrja në kohë janë vendimtare për shpëtimin e jetëve.
Stërvitje të tilla ndërinstitucionale shërbejnë jo vetëm për të testuar procedurat dhe kapacitetet ekzistuese, por edhe për të konsoliduar ndërveprimin ndërmjet strukturave që angazhohen në situata emergjente. Përmes trajnimit dhe praktikës së përbashkët, institucionet rrisin gatishmërinë dhe aftësinë për të vepruar në mënyrë të koordinuar kur kërkohet reagim i menjëhershëm.
Stërvitemi sot, për të qenë të gatshëm nesër.

STAFI

ANJEZA MUSOLLARI
Shefe e Sektorit të Botimeve & Kryeredaktor

Redaktore/ korrektore:
Suela **HODA**

Graphic Designer:
Afërdita **HYSAJ**

ADRESA:
Rruga e Dibrës/ Garnizoni "Skënderbej"



SHQIPËRIA, ALEATE ME ROL NË RRITJE NË SIGURINË EUROATLANTIKE

Takimi Rama – Rutte në Bruksel, në fokus sfidat e reja të sigurisë, modernizimi i mbrojtjes, Korridori VIII dhe përgatitjet për Samitin e NATO-s, në Tiranë





Në një mjedis ndërkombëtar ku siguria euroatlantike përballet me sfida gjithnjë e më komplekse, Shqipëria vijon të konsolidojë rolin e saj si një aleate e angazhuar dhe me përgjegjësi në rritje brenda NATO-s. Këtë dimension të politikës së sigurisë dhe mbrojtjes e përcolli edhe takimi i zhvilluar në Bruksel ndërmjet Kryeministrit Edi Rama dhe Sekretarit të Përgjithshëm të NATO-s, Mark Rutte, ku në qendër të diskutimeve ishin zhvillimet e sigurisë euroatlantike, forcimi i bashkëpunimit strategjik dhe kontributi i Shqipërisë në përmbushjen e objektivave të përbashkëta të Aleancës.

Takimi në Selinë e NATO-s u zhvillua në një kohë kur arkitektura e sigurisë në Evropë dhe më gjerë po përballet me kërcënime që nuk kufizohen më vetëm në dimensionin tradicional ushtarak. Kërcënimet hibride, sulmet kibernetike, dezinformimi, ndërhyrjet e huaja dhe cenimi i infrastrukturave kritike janë tashmë pjesë e një mjedisi sigurie që kërkon përgjigje të koordinuara, kapacitete të avancuara dhe një bashkëpunim të vazhdueshëm ndërmjet vendeve aleate.

Në këtë kuadër, bashkërendimi me NATO-n merr një rëndësi të veçantë për Shqipërinë. Përballja me kërcënimet moderne kërkon jo vetëm kapacitete të fuqishme ushtarake, por edhe ndërveprim të institucioneve, shkëmbim informacioni, zhvillim të ekspertizës dhe rritje të qëndrueshmërisë së strukturave shtetërore dhe shoqërisë ndaj krizave.

KËRCËNIMET HIBRIDE, SFIDË PËR SIGURINË KOLEKTIVE

Një nga çështjet e rëndësishme të trajtuara gjatë takimit ishte forcimi i bashkëpunimit në përballimin e kërcënimeve hibride. Në realitetin e sotëm strategjik, siguria nuk përcaktohet vetëm nga aftësia për të mbrojtur territorin, por edhe nga aftësia për të garantuar funksionimin e institucioneve, infrastrukturës kritike, sistemeve të komunikimit dhe shërbimeve jetike përballë kërcënimeve të natyrave të ndryshme.

Sulmet kibernetike dhe fushatat e dezinformimit, ndërhyrjet e huaja dhe përpjekjet për të cenuar infrastrukturat kritike kërkojnë një qasje të integruar. Për këtë arsye, forcimi i rezistencës kombëtare dhe ndërveprueshmërisë me strukturat e NATO-s është bërë një prej prioriteteve të rëndësishme të sigurisë.

Për Shqipërinë, ky angazhim lidhet drejtpërdrejt edhe me procesin e modernizimit të Forcave të Armatosura, zhvillimin e kapaciteteve të reja dhe rritjen e aftësive për t'iu përgjigjur një spektri më të gjerë kërcënimesh.

Në këtë mjedis, Aleanca kërkon nga vendet anëtare jo vetëm kontribut ushtarak, por edhe aftësi për të garantuar reziliencën kombëtare, mbrojtjen e infrastrukturës kritike dhe funksionimin e sistemeve strategjike në situata krize.

KORRIDORI VIII, NJË PROJEKT ME DIMENSION STRATEGJIK

Një tjetër çështje me rëndësi strategjike ishte zhvillimi i **Korridorit VIII** si korridor i mobilitetit ushtarak, që lidh Adriatikun me Detin e Zi.

Rëndësia e këtij korridori shkon përtej dimensionit të transportit dhe zhvillimit ekonomik. Në perspektivën e sigurisë dhe mbrojtjes, infrastruktura e mobilitetit ushtarak përbën një komponent të rëndësishëm të aftësisë së Aleancës për të lëvizur me shpejtësi personel, pajisje dhe kapacitete në drejtim të zonave ku mund të kërkohet reagim.

Për Shqipërinë, pozicioni gjeografik dhe dalja në Adriatik e bëjnë vendin një pikë me rëndësi në rrjetin e mobilitetit strategjik të krahut juglindor të NATO-s. Lidhja e hapësirës së Adriatikut me atë të Detit të Zi përmes Korridorit VIII krijon mundësi të reja për rritjen e ndërlidhjes, gatishmërisë dhe kapaciteteve logjistike.

Në këtë kuadër, zhvillimi i infrastrukturës nuk është thjesht një çështje ekonomike. Ai lidhet drejtpërdrejt me aftësinë për të garantuar lëvizshmëri, reagim të shpejtë dhe mbështetje logjistike në funksion të sigurisë kolektive.

PORTO ROMANO, INFRASTRUKTURË NË MBËSHTETJE TË NEVOJAVE STRATEGJIKE

Në diskutime u trajtua edhe rëndësia e projektit të **Porto Romanos**, në funksion të zhvillimit të kapaciteteve infrastrukturore dhe logjistike që mund të mbështesin nevojat strategjike të Aleancës.

Investimet në infrastrukturë me rëndësi strategjike përbëjnë një element të rëndësishëm të forcimit të kapaciteteve kombëtare dhe të kontributit që Shqipëria mund të japë në sigurinë kolektive.

Në kushtet kur mobiliteti ushtarak, kapacitetet logjistike dhe aftësia për të mbështetur operacionet janë bërë gjithnjë e më të rëndësishme, projekte të tilla marrin një dimension të veçantë edhe në funksion të kërkesave të NATO-s për rritjen e gatishmërisë dhe aftësisë së reagimit.

SAMITI I NATO-s NË TIRANË, NJË MOMENT I RËNDËSISHËM PËR SHQIPËRINË

Gjatë takimit në Bruksel u rikonfirmua gjithashtu mbajtja në Tiranë e Samitit të radhës të NATO-s, në vijim të vendimit të marrë nga vendet aleate.

Për Shqipërinë, organizimi i këtij samiti përbën një moment me rëndësi të veçantë. Ai e vendos vendin në qendër të një prej ngjarjeve më të rëndësishme të agjendës politike dhe strategjike të Aleancës dhe njëkohësisht përforcon profilin e Shqipërisë si një vend anëtar aktiv, i besueshëm dhe i angazhuar në çështjet e sigurisë kolektive.

Tirana do të jetë kështu vendi ku liderët e vendeve aleate do të mblidhen për të diskutuar çështje që lidhen me të ardhmen e sigurisë euroatlantike. Ky është një përgjegjësi e rëndësishme për Shqipërinë, por njëkohësisht edhe një mundësi për të evidentuar kontributin e saj në Aleancë dhe rëndësinë strategjike të Ballkanit Perëndimor.

Në një mjedis ndërkombëtar të karakterizuar nga pasiguri të shtuara dhe sfida të ndërlikuara gjeopolitike, Samiti i NATO-s në Tiranë do të sjellë në qendër të vëmendjes edhe perspektivën e rajonit, duke riafirmuar rëndësinë e Ballkanit Perëndimor për stabilitetin dhe sigurinë euroatlantike.

MODERNIZIMI I MBROJTJES, PRIORITET I SHQIPËRISË

Në këtë panoramë të re të sigurisë, modernizimi i Forcave të Armatosura mbetet një prej komponentëve kryesorë të angazhimit të Shqipërisë në NATO.

I pranishëm në takimin e zhvilluar në Selinë e NATO-s në Bruksel ishte edhe ministri i Mbrojtjes i Republikës së Shqipërisë, z. Ermal Nufi.

Gjatë vlerësimit të rezultateve të takimit, ministri Nufi nënvizoi rëndësinë e mesazheve të marra dhe ecurinë e sektorit të mbrojtjes në Shqipëri.

"Vlerësimet dhe inkurajimi për ecurinë e sektorit të mbrojtjes në Shqipëri janë motivim për të vijuar me vendosmëri rrugën e modernizimit dhe forcimit të kapaciteteve tona në mbrojtje e siguri", - u shpreh ministri Nufi.

Në vijim, ai nënvizoi edhe angazhimin e Shqipërisë ndaj detyrimeve në kuadër të Aleancës:

"Shqipëria mbetet një aleate serioze dhe e përkushtuar, e vendosur për të përmbushur detyrimet e saj në NATO dhe për të dhënë një kontribut gjithnjë e më të rëndësishëm në sigurinë kolektive dhe mbrojtjen e vlerave të Aleancës."

Këto vlerësime pasqyrojnë një prej drejtimeve kryesore të politikës shqiptare të mbrojtjes: ndërtimin e një force të aftë, moderne dhe të ndërveprueshme me aleatët, e cila jo vetëm përmbush detyrimet kombëtare, por kontribuon në mënyrë konkrete në operacionet, misionet dhe strukturat e sigurisë së përbashkët.

NGA KONTRIBUTI NË ALEANCË TEK PËRGJEGJËSIA STRATEGJIKE

Anëtarësimi në NATO i ka dhënë Shqipërisë një dimension të ri në fushën e sigurisë, por njëkohësisht ka sjellë edhe përgjegjësi të reja. Sot, roli i një vendi aleat matet jo vetëm me pjesëmarrjen formale në strukturat e Aleancës, por me kapacitetin për të kontribuar në mënyrë të besueshme në sigurinë kolektive.

Shqipëria ka vijuar të jetë pjesë e misioneve dhe angazhimeve të NATO-s, ndërsa Forcat e Armatosura kanë konsoliduar ndërveprueshmërinë me forcat aleate dhe kanë zhvilluar kapacitete që u përgjigjen kërkesave të reja operacionale.

Nga mbrojtja kibernetike te mobiliteti ushtarak, nga infrastruktura strategjike te gatishmëria operacionale, dimensioni i sigurisë është zgjeruar dhe kërkon një qasje gjithnjë e më të integruar.

Në këtë realitet, Shqipëria nuk është më vetëm një vend që përfiton nga siguria e Aleancës. Ajo është një aleate që merr përsipër përgjegjësi dhe kontribuon në ndërtimin e saj.

Takimi në Bruksel, zhvillimet që lidhen me Korridorin VIII dhe Porto Romanon, si dhe përgatitjet për Samitin e NATO-s në Tiranë, janë pjesë e një tabloje më të gjerë të këtij angazhimi.

Në qendër të kësaj tabloje qëndron një objektiv i qartë: **një Shqipëri me kapacitete më të fuqishme mbrojtëse, më e aftë për të përballuar kërcënimet e reja dhe më e integruar në mekanizmat e sigurisë kolektive të NATO-s**. Samiti i ardhshëm në Tiranë do të jetë një moment i rëndësishëm për ta dëshmuar këtë rol. Për Shqipërinë, ai nuk do të jetë vetëm një ngjarje ndërkombëtare e përmasave të larta, por edhe një mundësi për të treguar se përgjegjësia e një aleati matet me gatishmërinë për të kontribuar, me kapacitetet që ndërton dhe me vendosmërinë për të mbrojtur së bashku vlerat mbi të cilat është ngritur Aleanca.



SHQIPËRIA FORCON BASHKËPUNIMIN RAJONAL

NË KËRKIM-SHPËTIMIN AERONAUTIK

Zëvendësministrja e Mbrojtjes, Blerina Abrazhda, në takimin e dytë të Komitetit Këshillues Rajonal të RASARAC



Zëvendësministrja e Mbrojtjes, Blerina Abrazhda, mori pjesë në takimin e dytë të Komitetit Këshillues Rajonal të Kërkim-Shpëtimit Aeronautik (RASARAC) për vitin 2026, organizuar nga Qendra Kombëtare e Kërkim-Shpëtimit (QKKSH).

Takimi kishte në fokus forcimin e bashkëpunimit rajonal në fushën e kërkim-shpëtimit, koordinimin e operacioneve, vlerësimin e kapaciteteve dhe aseteve SAR të vendeve anëtare, si dhe lehtësimin e procedurave për zhvillimin e operacioneve ndërkufitare.

Gjatë fjalës së saj, zëvendësministrja Abrazhda theksoi angazhimin e Shqipërisë për ndërtimin e një sistemi kërkim-shpëtimi më të fuqishëm, me kapacitete të larta operacionale dhe reagim sa më efikas ndaj situatave emergjente. Ajo nënvizoi se zhvillimi i këtyre kapaciteteve përbën jo vetëm një përparësi kombëtare, por edhe një përgjegjësi të përbashkët rajonale dhe ndërkombëtare.

Në kuadër të aktivitetit u zhvilluan gjithashtu mbledhja e 28-të e Grupit të Ekspertëve dhe mbledhja e 29-të e Bordit Drejtues të vendeve anëtare të RASARAC. Diskutimet u përqendruan në çështje të bashkëpunimit operacional, koordinimit ndërmjet strukturave përgjegjëse dhe përmirësimit të mekanizmave të reagimit në situata emergjente.

Takimi i RASARAC shërbeu edhe si një mundësi për shkëmbimin e përvojave dhe praktikave më të mira ndërmjet vendeve anëtare, me synim rritjen e ndërveprimit dhe efektivitetit të strukturave të kërkim-shpëtimit aeronautik.

Ky aktivitet i paraprin zhvillimit të stërvitjes ndërinstitucionale të kërkim-shpëtimit aeronautik **SAREX-2026**, e cila synon testimin e gatishmërisë operacionale të strukturave pjesëmarrëse dhe forcimin e koordinimit ndërinstitucional në përballimin e situatave emergjente.

Përmes angazhimit në mekanizmat rajonalë të kërkim-shpëtimit, Shqipëria vijon të kontribuojë në forcimin e kapaciteteve të përbashkëta dhe në krijimin e një sistemi më të koordinuar e më efikas për reagimin ndaj emergjencave aeronautike.

FORCIMI I BASHKËPUNIMIT USHTARAK MES SHQIPËRISË DHE KOSOVËS

Shkëmbim përvojash, zhvillim kapacitetesh dhe partneritet në funksion të sigurisë së përbashkët

Bashkëpunimi ushtarak mes Shqipërisë dhe Kosovës vijon të konsolidohet përmes shkëmbimit të përvojave, zhvillimit të kapaciteteve dhe angazhimeve të përbashkëta në fusha me rëndësi për sigurinë dhe mbështetjen operacionale. Në këtë kuadër, komandanti i Komandës Mbështetëse, gjeneral brigade Aleksandër Pando, së bashku me delegacionin shqiptar, zhvilloi një vizitë zyrtare në Komandën e Logjistikës dhe Gardën Kombëtare të Forcës së Sigurisë së Kosovës (FSK).

Vizita shërbeu si një mundësi për të njohur nga afër strukturat, kapacitetet dhe zhvillimet e FSK-së, duke vendosur në fokus veçanërisht fushën e logjistikës, mbështetjes mjekësore dhe mbështetjes së autoriteteve civile.

Gjatë takimeve dhe vizitave në strukturat përkatëse, delegacioni shqiptar u njoh me misionin dhe mënyrën e organizimit të kapaciteteve të FSK-së, si dhe me praktikat e ndjekura për garantimin e mbështetjes së nevojshme në situata të ndryshme operacionale dhe emergjente.

LOGJISTIKA DHE MBËSHTETJA, KAPACITETE TË RËNDËSISHME

Logjistika përbën një prej shtyllave themelore të çdo force të aftë për të përmbushur me sukses misionin e saj. Aftësia për të siguruar në kohë personelin, pajisjet, furnizimet dhe mbështetjen e nevojshme është përcaktuese për vijueshmërinë dhe efektivitetin e çdo angazhimi operacional.

Në këtë drejtim, shkëmbimi i përvojave mes strukturave shqiptare dhe atyre të FSK-së krijon mundësi për përmirësimin e praktikave, identifikimin e sfidave të përbashkëta dhe forcimin e kapaciteteve që mbështesin operacionet.

Një vëmendje e veçantë gjatë vizitës iu kushtua edhe mbështetjes mjekësore, si një komponent i rëndësishëm i sigurisë së personelit dhe i aftësisë së forcave për të vepruar në kushte të ndryshme operacionale.

Po kështu, përfshirja e forcave në mbështetje të autoriteteve civile dëshmon rëndësinë e kapaciteteve ushtarake në përballimin e emergjencave dhe situatave që kërkojnë reagim të koordinuar institucional.

KËRKIM-SHPËTIMI MALOR, NJË FUSHË E PËRBASHKËT BASHKËPUNIMI

Një moment i rëndësishëm i vizitës ishte pjesëmarrja e gjeneral brigade Aleksandër Pandos në ceremoninë e përfundimit të Kursit të Kërkim-Shpëtimit Malor, të zhvilluar në kuadër të bashkëpunimit ndërmjet dy forcave.

Përgatitja në fushën e kërkim-shpëtimit malor kërkon nivel të lartë profesionalizmi, aftësi fizike, njohje të terrenit dhe koordinim të përsosur të ekipeve në situata ku koha dhe saktësia e ndërhyrjes janë vendimtare.

Përfundimi i këtij kursi përbën një tjetër tregues të rëndësisë që i kushtohet zhvillimit të kapaciteteve të përbashkëta dhe shkëmbimit të ekspertizës mes strukturave ushtarake të Shqipërisë dhe Kosovës.

Trajnime të tilla kanë vlerë të veçantë jo vetëm për rritjen e aftësive individuale dhe kolektive të efektivëve, por edhe për krijimin e një kulture të përbashkët operacionale, e cila lehtëson bashkëpunimin në rastet kur kërkohet ndërhyrje e koordinuar.



BASHKËPUNIMI USHTARAK, PJESË E NJË PARTNERITETI TË QËNDRUESHËM

Në vijim të vizitës, gjeneral brigade Pando zhvilloi një takim edhe me Ambasadorin e Republikës së Shqipërisë në Kosovë, Sh. T. z. Petrit Malaj.

Takimi përbëri një tjetër moment të rëndësishëm të vizitës, në funksion të koordinimit dhe forcimit të bashkëpunimit institucional, duke vlerësuar rëndësinë e marrëdhënieve të ngushta mes dy vendeve dhe institucioneve të tyre të sigurisë dhe mbrojtjes.

Bashkëpunimi ndërmjet Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë dhe Forcës së Sigurisë së Kosovës është mbështetur ndër vite mbi shkëmbimin e përvojave, trajnimin, zhvillimin e kapaciteteve dhe bashkërendimin në fusha me interes të përbashkët.

Ky partneritet merr një rëndësi të veçantë edhe në kushtet e sfidave të reja të sigurisë, ku aftësia për të bashkëpunuar, për të ndarë përvojën dhe për të reaguar në mënyrë të koordinuar është gjithnjë e më e rëndësishme.

PARTNERITET DHE SOLIDARITET NË SHËRBIM TË SIGURISË

Vizita e delegacionit shqiptar në Kosovë riafirmoi angazhimin e përbashkët për thellimin e partneritetit, shkëmbimin e përvojave dhe rritjen e kapaciteteve, në funksion të sigurisë së përbashkët.

Nga logjistika dhe mbështetja mjekësore, te kërkim-shpëtimi malor dhe mbështetja e autoriteteve civile, bashkëpunimi mes dy forcave shtrihet në fusha që kërkojnë profesionalizëm, gatishmëri dhe ndërveprim të vazhdueshëm.

Në këtë drejtim, çdo vizitë, trajnim apo aktivitet i përbashkët shërben për të ndërtuar më tej besimin, për të ndarë praktikat më të mira dhe për të rritur aftësinë e strukturave për t'iu përgjigjur sfidave të sigurisë. Bashkëpunim, partneritet dhe solidaritet në shërbim të sigurisë!





SIGURIA KIBERNETIKE, PRIORITET PËR FORCIMIN E REZISTENCËS DHE KAPACITETEVE

Zëvendësministrja e Mbrojtjes, znj. Pranvera Skana, në Konferencën Kombëtare për Sigurinë Kibernetike

Zëvendësministrja e Mbrojtjes, znj. Pranvera Skana, mori pjesë në Konferencën Kombëtare për Sigurinë Kibernetike, organizuar nga Autoriteti Kombëtar për Sigurinë Kibernetike (AKSK), me temë **"Rritja e Rezistencës Kibernetike: Forcimi i Linjës së Parë të Mbrojtjes"**.

Në kuadër të konferencës, znj. Skana ishte pjesë e panelit me temë **"Më shumë rregulla, më shumë përgjegjësi, më pak ekspertë: Si ta kapërcejmë hendekun e kapaciteteve në sigurinë kibernetike?"**, ku ndau perspektivën e Forcave të Armatosura Shqiptare mbi rëndësinë e zhvillimit të burimeve njerëzore dhe përfshirjes së brezit të ri në këtë fushë strategjike.

Gjatë diskutimit, zëvendësministrja e Mbrojtjes theksoi rëndësinë që FARSH-të i kushtojnë përfshirjes së të rinjve, profesionistëve të teknologjisë së informacionit dhe studentëve në fushën e sigurisë kibernetike. Sipas saj, krijimi i mundësive për talentet e reja dhe zhvillimi i ekspertizës profesionale janë elementë thelbësorë për përballimin e sfidave të reja të sigurisë.

"Në një botë gjithnjë e më digjitale, mbrojtja e hapësirës kibernetike është po aq e rëndësishme sa mbrojtja e integritetit territorial të vendit", - u shpreh znj. Skana gjatë fjalës së saj.

Konferenca bëri bashkë përfaqësues të institucioneve shtetërore, operatorëve të infrastrukturave kritike, sektorit privat dhe partnerëve ndërkombëtarë, duke krijuar një hapësirë të përbashkët për shkëmbimin e përvojave dhe identifikimin e sfidave në fushën e sigurisë kibernetike.

Në fokus të diskutimeve ishin forcimi i rezistencës kibernetike, përgatitja dhe reagimi ndaj incidenteve, garantimi i vazhdimësisë së shërbimeve jetike, si dhe



adresimi i mungesës së specialistëve të kualifikuar.

Për Forcat e Armatosura, zhvillimi i kapaciteteve në fushën kibernetike përbën një komponent të rëndësishëm të përgatitjes për sfidat e sigurisë moderne. Në këtë drejtim, investimi te njerëzit, veçanërisht te brezi i ri dhe profesionistët e teknologjisë, shihet si një domosdoshmëri për krijimin e kapaciteteve të qëndrueshme dhe të afta për t'iu përgjigjur kërcënimeve gjithnjë e më komplekse.

Qëllimi i konferencës ishte nxitja e bashkëpunimit ndërinstitucional dhe ndërsektorial, si dhe forcimi i kapaciteteve kombëtare për përballimin e kërcënimeve kibernetike, duke kontribuar në garantimin e një mbrojtjeje më të qëndrueshme dhe efektive të hapësirës digjitale.

RKV PËRZGJEDH "USHTARIN DHE NËNOFICERIN E VITIT 2026"

14 efektivë u përballën me katër disiplina që testuan përgatitjen fizike, aftësitë profesionale dhe qëndrueshmërinë ushtarake

Në Regjimentin e Këmbësorisë së Veriut (RKV), në kuadër të vlerësimit të përgatitjes dhe aftësive profesionale të efektivëve, u zhvillua gara për përzgjedhjen e **"Ushtarit dhe Nënoficerit të Vitit 2026"**. Aktiviteti synoi të evidentojë nivelin e përgatitjes fizike, njohuritë teorike, aftësitë praktike dhe qëndrueshmërinë e personelit në përballimin e sfidave të ndryshme ushtarake.

Në garë morën pjesë 14 efektivë, të cilët u testuan në katër disiplina: Testin e Përgatitjes Fizike (TUPF), testimin teorik, navigimin tokësor dhe vrapimin taktik 15 kilometra me ngarkesë.
Secila prej disiplinave kërkoi përgatitje të veçantë, përqendrim dhe aftësi për të vepruar nën presion. Testimi fizik vlerësoi parametrat e qëndrueshmërisë dhe forcës, ndërsa provimi teorik vuri në provë njohuritë profesionale





dhe ushtarake të pjesëmarrësve. Navigimi tokësor testoi orientimin dhe aftësinë për të përmbushur detyrën në terren, ndërsa vrapimi taktik 15 kilometra me ngarkesë vlerësoi rezistencën fizike dhe mendore, disiplinën dhe vendosmërinë e garuesve.

Gara për **"Ushtarin dhe Nënoficerin e Vitit"** përfaqëson një veprimtari të rëndësishme në funksion të evidentimit dhe vlerësimit të standardeve profesionale të personelit. Ajo nxit konkurrencën e shëndetshme, motivimin dhe përmirësimin e vazhdueshëm të aftësive individuale e kolektive.
Përmes aktiviteteve të tilla, Regjimenti i Këmbësorisë së Veriut vijon të promovojë vlerat themelore të shërbimit ushtarak: përkushtimin, disiplinën, profesionalizmin, qëndrueshmërinë dhe shpirtin e garës.
Urime efektivëve fitues për rezultatet e arritura dhe suksese në fazën e ardhshme të konkurrimit!

PROF. DR. PROLETAR HASANI:

Historia ushtarake nuk është vetëm kujtesë e së kaluarës, por një përgjegjësi për të ardhmen



Intervistoi: ANJEZA MUSOLLARI,
Shefe e Sektorit të Botimeve

Nga uniforma te historia, nga përvoja e komandantit te përgjegjësia e studiuesit, rruga profesionale e Prof. Dr. Hasanit përbën një dëshmi të një marrëdhënieje të gjatë me institucionin ushtarak dhe me dijen që buron prej tij. Që prej vitit 1969, ai ka shërbyer në Forcat e Armatosura, kryesisht në Shkodër, duke ushtruar detyra të ndryshme ushtarake dhe drejtuese e duke arritur gradën e kolonelit.

Kolonel në rezervë, historian ushtarak, pedagog dhe studiues, Prof. Dr. Proletar Hasani i përket atij brezi ushtarakësh që e kanë përjetuar ushtrinë në disa dimensione: në uniformë, në komandë, në auditor dhe në kërkimin shkencor. Për dekada me radhë, ai ka qenë pjesë e jetës së Forcave të Armatosura Shqiptare, duke nisur rrugëtimin si tankist e komandant dhe duke vijuar më pas në fushën e arsimit, të kërkimit dhe të historiografisë ushtarake.

Nga uniforma te historia, nga përvoja e komandantit te përgjegjësia e studiuesit, rruga profesionale e Prof. Dr. Hasanit përbën një dëshmi të një marrëdhënieje të gjatë me institucionin ushtarak dhe me dijen që buron prej tij. Që prej vitit 1969, ai ka shërbyer në Forcat e Armatosura, kryesisht në Shkodër, duke ushtruar detyra të ndryshme ushtarake dhe drejtuese e duke arritur gradën e kolonelit.

Por përvoja e uniformës nuk do të mbetej vetëm në kujtesën e tij personale. Ajo do të shndërrohej në një bazë të rëndësishme për veprimtarinë akademike dhe shkencore. Si pedagog dhe drejtues në strukturat e arsimit ushtarak, përfshirë edhe detyrën e **Kryetarit të Këshillit të Profesorëve**, Prof. Dr. Hasani ka dhënë kontribut në përgatitjen profesionale dhe intelektuale të brezave të oficerëve dhe studentëve të sigurisë.

Në një periudhë kur ushtria shqiptare ka kaluar transformime të rëndësishme, ai ka zgjedhur të mbetet njëkohësisht edhe **dëshmitar, studiues dhe interpretues i historisë së saj**. Për të, historia ushtarake nuk është thjesht një renditje datash, operacionesh, komandash apo figurash. Ajo është përvoja e akumuluar e një institucioni, është kujtesa e njerëzve që kanë shërbyer në uniformë dhe, mbi të gjitha, është një burim mësimesh për brezat që vijnë.

Prof. Dr. Proletar Hasani është autor dhe bashkautor i një sërë botimesh e studimesh në fushën e historisë ushtarake, arsimit ushtarak, organizimit të Forcave të Armatosura dhe personaliteteve ushtarake shqiptare. Ndër veprat e tij kryesore janë:

- *Historia e Artit Ushtarak gjatë LANÇ të popullit shqiptar, 1939-1944*, Akademia Ushtarake, Tiranë, 1987, bashkautor.
- *Ju prezantohet Shqipëria*, Shtëpia Botuese e Ushtrisë (SHBU), Tiranë, 1995, bashkautor, në dy gjuhë, shqip-anglisht.
- *Personalitete ushtarake në vite, 1912-1997*, Tiranë, 1997, bashkautor.
- *Histori e pashkruar*, Tiranë, 1999.
- *Historia e Ushtrisë Shqiptare (Organizimi), 1912-1944*, botimi i parë, SHBU, Tiranë, 2000, bashkautor.
- *Kush e ka drejtuar Ushtrinë Shqiptare*, Tiranë, 2000.
- *Fjalori Enciklopedik Shqiptar (FESH-1)*, Akademia e Shkencave e RPSSH.
- *Fjalori Enciklopedik Shqiptar (FESH)*, botim i ri, Tiranë, në tre vëllime: Vëllimi I dhe II, 2008; Vëllimi III, 2009.
- *Historia e Ushtrisë Shqiptare – Pjesa e parë*, Tiranë, 2008, tekst mësimor, bashkautor.
- *Historia e Ushtrisë (Nga Lashtësia – 1945)*, Qendra e Shtypit, Botimeve dhe Përkthimeve Ushtarake, Tiranë, 2008.
- *Drejt Perëndimit – Historia e arsimit të ushtarakëve shqiptarë në Perëndim, në vitet 1913-1944*, Akademia e Mbrojtjes "Spiro Moisiu", Tiranë, 2011.
- *Me fytyrë nga Perëndimi*, Tiranë, 2014, bashkautor.
- *Histori Lidershipi*, Tiranë, 2014, bashkautor.
- *Historia e Ushtrisë Shqiptare, 1912-1939*, botim i ri, Tiranë, 2023, bashkautor.
- *Në rrjedhat e luftës...*, Tiranë, 2025.

Këto botime dëshmojnë një veprimtari të gjerë dhe të vazhdueshme në fushën e **historisë ushtarake shqiptare**, duke përfshirë organizimin dhe zhvillimin e ushtrisë, artin ushtarak, arsimin dhe formimin e ushtarakëve, personalitetet ushtarake, lidershipin, si dhe periudha e ngjarje të rëndësishme të historisë kombëtare.

Një vend të veçantë në veprimtarinë e tij zë edhe **dokumentimi i përvojës ushtarake shqiptare dhe trajtimi i kontributeve që lidhen me luftën e UÇK-së**, duke e zgjeruar vështrimin e tij përtej kufijve të historisë së ushtrisë shqiptare dhe drejt zhvillimeve ushtarake e historike të hapësirës shqiptare.

Në këtë kuptim, Prof. Dr. Proletar Hasani është një figurë që bashkon tri përvoja: **atë të ushtarakut që e ka jetuar uniformën, të pedagogut që ka formuar breza dhe të historianit që ka kërkuar të dokumentojë e të shpjegojë të kaluarën ushtarake**.

Dhe pikërisht kjo e bën bashkëbisedimin me të të veçantë për faqet e **"Ushtrisë"**. Sepse të flasësh me një ushtarak-historian do të thotë të udhëtosh në kohë, por edhe të kërkosh përgjigje për të tashmen. Çfarë duhet të ruajmë nga përvoja? Çfarë duhet të korrigjojmë? Çfarë u mëson historia ushtarake brezave të rinj? Sa e rëndësishme është që ushtria të ketë kujtesën e saj profesionale? Dhe, mbi të gjitha, çfarë raporti duhet të ndërtojmë mes historisë, dijes dhe modernizimit të Forcave të Armatosura?

Në këtë intervistë, **Prof. Dr. Proletar Hasani** rikthehet te rrugëtimi i tij në uniformë, te përvoja e gjatë në strukturat ushtarake dhe akademike, te puna kërkimore dhe botimet e tij, por edhe te disa prej momenteve dhe zhvillimeve që kanë lënë gjurmë në historinë ushtarake shqiptare.

Është një bisedë për **ushtrinë, historinë, njerëzit e uniformës dhe kujtesën profesionale** – një rrëfim nga perspektiva e një njeriu që historinë ushtarake nuk e ka parë vetëm nga dokumentet dhe librat, por e ka përjetuar fillimisht nga vetë uniforma.

Cili është vlerësimi juaj për organizimin dhe drejtimin ushtarak të Ushtrisë NÇ gjatë viteve 1939 - 1944?

Pas agresionit ushtarak, pushtimit fashist të Shqipërisë, rënies së shtetit shqiptar dhe vendosjes së pushtetit të pushtuesve në vend nisi të marrë jetë dhe vrull edhe krijimi i forcave të armatosura, me synimin për të luftuar për çlirimin e vendit nga pushtuesit e huaj. Në këtë rrjedhë lindi dhe u formua edhe Ushtria NÇ Shqiptare, e cila u krijua nga Lëvizja Antifashiste NÇ dhe hap pas hapi u shndërrua në forcën e armatosur më të madhe e më të vendosur, e cila i shkoi deri në fund luftës kundër forcave pushtuese, deri në çlirimin e plotë të Shqipërisë dhe rikthimin e Pavarësisë nga pushtuesit fashistë.

Ushtria NÇ Shqiptare dallohej për veçoritë e saj, mes tyre dhe ato për organizimin dhe drejtimin ushtarak të veprimtarisë së saj luftarake.

Natyrisht ajo nuk u krijua dhe organizua brenda një dite. Përkundrazi, ajo kërkoi kohën e vet të nevojshme, sepse ky proces u krye në kohë të vështirë lufte, pa mbështetje nga institucionet e shtetit, i cili tashmë ishte realisht në duart e pushtuesve fashistë. Për rrjedhojë, krijimi i saj ndodhi gradualisht, nga formacioni më i vogël luftarak tek më i madhi.

Kësisoj, sipas dokumenteve dhe studimeve të derisotme, përfshi edhe ato më se tridhjetëvjeçare, që kam kryer unë rreth temës së Luftës NÇ dhe të UNÇSH-së, ajo ushtri u ngrit me tërë strukturat e veta nga më të voglat deri tek më të mëdhatë.

Në këtë rrjedhë, përmes vështirësive të panumërta, të pafavorshme në pikëpamje të organizimit dhe funksionimit ushtarak, u bë e mundur të ngriheshin, të merrnin jetë dhe nisën të vepronin që nga viti 1942, njësitet guerile, çetat, batalionet dhe grupet partizane. Më pas, në ecurinë e Luftës Antifashiste NÇ, me rritjen e saj në skenën (teatrin) shqiptar, duke filluar që nga vera e vitit 1943, u shfaq një formacion i ri, më i madhi deri atëherë në UNÇ në pikëpamje përmasash, në përbërje strukturore dhe numerike (që shkonte nga 3–5 batalione dhe efektiv nga 500-600 deri në 2000-2500 partizanë secila). Ishte brigadë sulmuese që, shumë shpejt u shndërrua në formacionin bazë luftarak, duke përthithur në përbërje të saj shumicën e formacioneve të deriatëhershme. Gjithsej u formuan 24 Br. Sulmuese.

Një hov dhe vrull të madh, shumë të dukshëm, Ushtria NÇ fitoi pas majit të vitit 1944 (Kongresit Antifashist të NÇ të Përmetit, të 24 majit 1944). Në harkun kohor që përfshinin muajt maj – deri 29 nëntor të këtij viti, me vendim të këtij kongresi, në përpjekje të UNÇSH-së u ngritën dhe organizuan formacionet më të mëdha ushtarake të saj, si divizioni sulmues dhe korporata. Gjithsej u formuan dhe vepruan në radhët e Ushtrisë NÇ, 8 (tetë) divizione sulmuese nga I tek VIII. Në secilin divizion bënin pjesë 3-4 brigada sulmuese. Ndërsa, duke filluar që pas 18 gushtit 1944, në strukturën organizative të Ushtrisë NÇ u formuan dhe u shtuan edhe 3 (tre) korparmata, formacion që përfshinte në përbërje 2-3 divizione sulmuese.

Kësisoj, deri më 29 nëntor të vitit 1944 në radhët e UNÇSH bënin pjesë 70 000 partizanë-ushtarë, të cilët ishin rreshtuar në 24 Brigada Sulmuese, 8 Divizione Sulmues dhe 3 Korparmata. Ndërkohë, në periudhën e fundit të LANÇ (Maj-Nëntor 1944), UNÇ u shndërrua në Ushtri të rregullt, u njësua drejtimi duke ngritur Komandën e Përgjithshme me një Komandant të Përgjithshëm në krye të saj, me gradën më të lartë ushtarake për atë kohë, duke larguar nga bashkëdrejtimi rolin e komisarit Politik, që ekzistonte deri atëherë dhe duke lënë në drejtim vetëm Komandantin e Përgjithshëm, si në ushtritë e rregullta klasike. Ndërkohë, krahas kësaj komande, mbeti edhe organizimi ushtarak i Shtabit madhor (Shtatmadhoria) që ndihmonte në planifikimin dhe drejtimin e operacioneve të



forcave e njësive të kësaj ushtrie.

Për t'i dhënë një karakter sa më ushtarak UNÇ-së, u vendosën gradat (ushtarake).

Nga Shtabi i Përgjithshëm, u hartuan dhe u vunë në përdorim disa dhjetëra e qindra qarkore e rregullore që i dhanë UNÇ-së përmbajtje e paraqitje formale dhe karakter ushtarak gjatë kryerjes së veprimeve luftarake, disiplinës, lëvizjes, manovrave, taktikës së luftimeve etj., kundër pushtuesve fashistë të vendit.

Përtej udhëheqjes partiake, shumë i rëndësishëm ishte edhe drejtimi i formacioneve luftarake të UNÇ-së. Sipas studimeve dhe botimeve të shumta kushtuar artit ushtarak të kësaj ushtrie, drejtimi ushtarak i reparteve dhe njësive të Ushtrisë NÇ, erdhi duke u përmirësuar dhe, në fazën e krijimit të batalioneve e, veçanërisht pas 10 Korrikut 1943, me formimin e Shtabit të Përgjithshëm dhe më tej të Komandës së Përgjithshme.

Nga ana tjetër, drejtimi ushtarak i formacioneve luftarake partizane të Ushtrisë NÇ Shqiptare brenda për brenda tyre, ka ndryshuar nga fillimet, gjatë ecurisë e deri në përfundimin e luftës.

Në fillimet e këtyre formacioneve, si në njësitë guerile, në çetat e batalionet, madje edhe në grupet partizane, drejtimi qendror realizohej përmes Komiteteve Qarkore të PKSH-së, i cili kishte një Përgjegjës Ushtarak pikërisht për organizimin, bashkëveprimin dhe çështje të tjera ushtarake, që u përkisnin këtyre formacioneve luftarake partizane. Ndërsa, vetë formacionet partizane, brenda për brenda, drejtoheshin nga komandat dhe shtabet e tyre, ndonëse modeste dhe me personel të pakët.

Një pamje e përmbajtje ndryshe mori drejtimi ushtarak në fazat pasuese të Luftës Antifashiste NÇ, kohë kur u formuan formacionet dhe njësitë e mëdha si grupet partizane, brigadat dhe divizionet sulmues e korparmatat e kësaj ushtrie. Këto formacione kishin shtabet, që tashmë përbëheshin nga pjesëtarë më të shumtë e më me përvojë luftarake e drejtimi, duke mbështetur dhe ndihmuar komandat e tyre në marrjen e vendimeve sa më realiste, si dhe për realizimin e drejtimit dhe komandimit te njësitë e tyre gjatë kryerjes së veprimeve luftarake me sukses në fushën e luftimit!

Ndërsa, në planin qendror, për drejtimin e veprimeve dhe operacioneve të formacioneve dhe, më tej, të njësive të mëdha të Ushtrisë NÇ, u ngritën organizma me karakter e përbërje ushtarake, të afta për planifikim e drejtim.

Siç dihet historikisht, më 10 Korrik 1943 u formua Shtabi i Përgjithshëm i Ushtrisë NÇ. Ky shtab ishte një organizëm i mirëfilltë drejtimi, organizimi dhe planizimi, i përpunimit, përcaktimit të taktikës së luftës. Ai merrej edhe me organizimin e bashkëveprimit të njësive e formacioneve të rregullta partizane të UNÇ-së midis tyre, por edhe me forcat vullnetare popullore të zonave të ndryshme të vendit.

Më pak se një vit më pas, në maj 1944, për drejtimin e UNÇSH-së të reformuar tanimë si një ushtri e rregullt, me njësi ushtarake të mëdha, si divizione sulmues dhe korparmata, në të cilat u vendosën edhe gradat ushtarake, u krijua Komanda e Përgjithshme e UNÇSH-së, e kryesuar nga një Komandant i Përgjithshëm.

Sipas dokumenteve, studimeve dhe vlerësimeve të shumta për UNÇSH-në, drejtimi ushtarak i saj ishte mjaft profesional për kohën dhe kushtet e atëhershme. Kjo ka ndodhur, përveç të tjerave, edhe sepse në krye të komandave e të shtabeve të disa formacioneve e njësive të kësaj ushtrie drejtuan edhe ish-ushtarakë, oficerë e nënoficerë me shkolla e akademi ushtarake, që iu bashkuan asaj në rrjedhën e Luftës Antifashiste NÇ.

Kishte edhe një dukuri apo veçori, që e lehtësonte drejtimin dhe komandimin ushtarak tek formacionet dhe njësitë luftarake të UNÇSH-së. Një pjesë e mirë e këtyre ushtarakëve u caktuan në komandat e shtabet e këtyre formacioneve e njësive të UNÇ-së dhe të organeve më të larta drejtuese qendrore të UNÇSH-së, si të Shtabit e më pas të Komandës së Përgjithshme etj.

Vetëm në përbërje të Shtabit të Përgjithshëm, që në përurimin e tij bënin pjesë edhe katër ushtarakë të karrierës, si Komandanti i këtij shtabi major Spiro Moisiu, Zëvendësi i tij, toger Dali Ndreu, anëtarët, toger Bedri Spahiu dhe major Abaz Kupi, shto këtu edhe oficerin rezervë Sejfulla Malëshova.

Megjithatë, kjo kategori drejtuesish zinte një vend më të paktë në raport me nevojat e UNÇSH-së për komandantë e drejtues të tjerë, të cilët u plotësuan më drejtues e komandantë pa shkollim ushtarak, por me përvojë të pasur luftarake, të fituar gjatë luftimeve të mëparshme. Si të thuash, këta ishin përgatitur e diplomuar në të ashtuquajturën "shkollën e luftës".

Në përfundim mund të them se, sipas mendimit e vlerësimit tim, organizimi dhe drejtimi ushtarak i UNÇ-së, karakteristikat dhe veçoritë e veta dalluese, krahas frymës luftarake, sakrificave të panumërta dhe përkushtimit të pjesëmarrësve të saj në luftën kundër pushtuesve të huaj, e çuan atë në çlirimin e plotë të vendit dhe rivendosjen e Pavarësisë së Shqipërisë.

Sa e rëndësishme është për brezat e rinj njohja e sakrificave dhe e organizimit të Ushtrisë partizane (UNÇSH)?

Teorikisht, njohja e Luftës Antifashiste NÇ, në tërësi edhe e Ushtrisë Partizane Vullnetare NÇ, që u ngritën dhe vepruan në kuadrin e viteve të Luftës së Dytë Botërore, kundër pushtuesve fashistë të Shqipërisë, natyrisht, ka qenë dhe mbetet me rëndësi të madhe të veçantë. Kjo pikërisht për shkak të rolit të padiskutueshëm të kësaj ushtrie në çlirimin e Shqipërisë, të sakrificave të panumërta dhe organizimit të saj ushtarak, si dhe të arritjeve të saj.

Njohja dhe vlerësimi i këtyre dukurive që kanë lidhje me Ushtrinë NÇ, luajnë një rol me shumë vlera në edukimin dhe vlerësimin e brezave të rinj në lidhje me vlerësimin e historisë së popullit shqiptar dhe vendin e tij në LANÇ e në Luftën e Dytë Botërore (L2B).

Nuk mund të them me siguri sa e rëndësishme është për brezat e rinj njohja e luftës së Ushtrisë NÇ, e sakrificave dhe e veçorive të organizimit të kësaj ushtrie, e sakrificave të panumërta e tejet kufijve të së paimagjinueshmes sot, deri në dhënien e jetës, bënë pjesëtarët e kësaj ushtrie deri në çlirimin e plotë të vendit nga pushtuesit fashistë.

Por, natyrisht, di me siguri se në ditët e sotme, kur kanë kaluar tetëdhjetë vite nga përfundimi i Luftës së Dytë Botërore, përfshi edhe Luftën Antifashiste NÇ të popullit shqiptar, kur zhvillimi i kësaj lufte mësohet e thjeshtëzuar vetëm nëpër librat e procesit akademik, kur veteranët e kësaj lufte gati janë larguar nga kjo jetë, duke lënë pas vetëm historinë dhe muzetë me trofetë e tyre (armatime, veshje, foto, dokumente, filma), në një kohë të mbushur me debate e diskutime, shpesh politike, mes historianëve që shkruajnë për këtë luftë dhe të tjerëve politikanë e njerëz që e kritikojnë, e mohojnë ose e përbaltin këtë luftë dhe Ushtrinë NÇ, e cilësojnë krejt civile e vëllavrasëse; të rinjtë dhe më shumë ata të brezave që vijnë, janë të heshtur e indiferent ndaj kësaj lufte dhe atyre që e bënë këtë luftë për çlirimin e Shqipërisë, e rikthimit të pavarësisë dhe sovranitetit të vendit!

Po ashtu, di me siguri se sa e rëndësishme është që brezat e rinj, të sotëm dhe të ardhshëm, duhet të mësojnë se sa shumë e deri në cilët kufij të së paimagjinueshmes kanë arritur sakrificat e pjesëtarëve të Ushtrisë Vullnetare Partizane NÇ. Brezat e rinj të sotëm e të së ardhmes në Shqipëri duhet të dinë se pjesëtarët e asaj ushtrie ishin bashkuar vullnetarisht me të dhe ishin bërë pjesë e saj, duke duruar sakrificat e shumta, që nga mungesa e ushqimit, strehimit, veshjeve, medikamenteve mjekësore, të armatimeve e municioneve të duhura, pa mbështetje financiare. Sakrificat e tyre (pjesëtarëve të UNÇ-së) arrinin deri në sublime e vetëmohuese, deri në dhënien e jetës në emër të lirisë, rikthimin e Pavarësisë së Shqipërisë, jo për dekorata, emër e tituj! Dhe të mendosh që mosha e tyre, deri në 80 për qind, ishte krejt e re, shkonte nga 15-25 vjeç!

Brezat e rinj duhet të dinë se Ushtria NÇ ishte krejt e veçantë edhe në pikëpamje të organizimit të brendshëm të saj.

Ajo u ngrit nga hiçi, krejtësisht mbi bazën e vullnetarizmit; u formua dhe organizua hap pas hapi nga formacioni më i vogël luftarak, që do të thotë nga njësitet guerile dhe çetat, tek batalionet e grupet partizane, për të shkuar më tej tek grupet e mëdha, si brigadat e divizionet Sulmues e për ta përmbyllur me korparmatat. Për drejtimin ushtarak të UNÇ-së, u përurua më 10 korrik 1943, Shtabi i Përgjithshëm dhe në maj 1944 edhe Komanda e përgjithshme e UNÇSH-së, që, së bashku me ngritjen e njësive të mëdha dhe vendosjen e gradave, i dha asaj përmasat dhe përmbajtjen e një ushtrie të rregullt.

Kjo ushtri përbëhej tërësisht nga këmbësorë, me pak shërbime e armë të rënda, të zëna armikut, dhe më pas, të mbështetur edhe nga misionet ushtarake anglo-amerikane. Ajo nuk kishte, në shumicë, në drejtim, ushtarakë (oficerë e nënoficerë) të karrierës, numri i tyre ishte i pakët në raport me drejtuesit që vinin nga "shkolla" e luftës.

Por, veçoritë që e karakterizonin dhe e dallonin UNÇ-në, që aty nga fundi i luftës u shndërrua në ushtri të rregullt. Ajo ishte forca e vetme që i shkoi luftës kundër pushtuesve deri në fund, deri në çlirimin e plotë të Shqipërisë, duke i kthyer vendit lirinë dhe Pavarësinë e humbur me pushtimin fashist, më 7 prill 1939.

Së fundi, do të theksoja se, njohja e sakrificave dhe e organizimit të Ushtrisë NÇ nga ana e brezave të rinj është me rëndësi për edukimin dhe formimin historik të tyre. Jam plotësisht i bindur se ka shumë vlera për njohje në këtë mes, të cilat i përkasin ushtrisë partizane NÇ, si histori, si përvojë, për kontributin për çlirimin e vendit, duke i luftuar deri në fund pushtuesit fashistë, se lufta bëhet edhe në forma dhe organizime klasike, por edhe në mënyra dhe ushtri jo klasike, vullnetare.

Kësisoj brezat e rinj do të kuptojnë se atdheu ynë i përbashkët, Shqipëria, jo vetëm duhet zhvilluar e përparuar për ta demokratizuar, për ta begatuar në pikëpamje sociale dhe ekonomike, etj., por edhe duhet ta mbrojmë atë në rrethana tejet të vështira!

Cili nga librat tuaj është më i dashuri dhe pse...?

Kjo është një pyetje e vështirë që vë në mëdyshje çdo autor, sepse për këdo prej tyre librat janë pjesë e shtrenjtë e jetës dhe e krijimtarisë së tyre!

Kështu ndodh edhe me mua si autor i vjetër, i disa librave e shkrimeve të publikuara gjatë veprimtarisë time më se dyzetvjeçare studimore e akademike, që kanë ecur së bashku. Pastaj, shkrimi e botimi i çdo libri është i lidhur ngushtësisht me kohën, rrethana, ngjarje apo projekte të caktuara, gjë që e

kanë ndikuar botimin përkatës.

Gjithsesi, unë mund të veçoj jo me qejf ndonjë prej librave të krijimtarisë time. Këtë veprim apo dallim e bëj jo sepse ai vlen më shumë se të tjerët, por sepse me të më kanë lidhur koha, situata ose ngjarje dhe personazhe.

Në fillimet e studimeve të larta dhe gjatë kualifikimit pasuniversitar kam qenë i lidhur ngushtësisht dhe më shtynte ideja për të kërkuar e për të shkruar për disa personalitete ushtarake dhe, natyrisht edhe për liderët e lidershipin ushtarak shqiptar. Kjo ide më tërhiqte, duke parë se sa e parrahur e djerrë ishte kjo temë në Shqipëri, ndërkohë personazhet ishin të shumtë dhe fare pak ose aspak të njohur përmes botës së letrave!

Për rrjedhojë, kur nisa punën në fushën e studimeve dhe asaj akademike pranë Akademisë Ushtarake (më pas e Shtabit të Përgjithshëm, ndërsa sot e Forcave të Armatosura) në Degën dhe Katedrën e Historisë së Artit Ushtarak, siç emërtoheshin ende në fundin e viteve shtatëdhjetë të Shek. XX, mundësitë për të vënë në jetë idetë e mia të hershme u shtuan. Kësisoj mund të mbledh të dhëna për disa personalitete ushtarakë shqiptarë që kishin vepruar e drejtuar strukturat e niveleve të ndryshme të Ushtrisë Shqiptare në periudha të ndryshme të historisë së saj, nga viti 1912 deri më 1997. Kështu, në bashkautorësi me Prof. Asc. Dr. Gjergj Titanin u shkrua dhe botua libri "Personalitete Ushtarake Shqiptare, 1912-1993". Libri doli nga shtypi në dhjetorin e vitit 1997.

Në vijim të konkretizimit të kësaj ideje, në vitin 2001 nxora në dritë librin tjetër me titull "Kush e ka drejtuar Ushtrinë Shqiptare". Kurse në vitet pasuese lënda e këtij libri u pasurua edhe me personazhe të tjerë dhe me të dhëna të reja të shumta, për t'u publikuar nën një titull të ri, "Histori Lidershipi", botuar në vitin 2017. Kësaj radhe bashkautor ishte studiuesi i Historisë Ushtarake dhe bashkëpunëtori im i vjetër, Dr. Asllan Zemani.

Por natyrisht që libri që më ka lidhur më së shumti me fushën e studimeve për Historinë Ushtarake, ka qenë studimi shumëvëllimësh që i përket projektit madhor kushtuar Historisë së Ushtrisë Shqiptare (në tre vëllime), i cili përfshin periudhat 1912-1939, 1939-1944 dhe 1945-1990.

Drejt pëlqimit të dëshirës për t'u marrë me kërkime e studime për Historinë e Ushtrisë Shqiptare, më ka shtyrë kureshtja dhe interesimi për të zbardhur, shkruar, dhe për të bërë publike (të njohur) këtë histori pak dhe aspak të njohur e fare pak të pasqyruar edhe në historinë e popullit shqiptar.

Tematika që ngërthen këtë vepër, si pjesë e pandashme e historisë së popullit shqiptar është mjaft e pasur dhe të tërheq me ngjarje, dukuri e personazhe të shumtë, të cilët kanë luajtur një rol të rëndësishëm në ecurinë e vendit.

Një tjetër pëlqim e lidhje me krijimtarinë time shkencore, i cili ka ardhur si rrjedhojë logjike e orientimit, qysh në fillimet e punës dhe të karrierës time shkencore e akademike, ka qenë dhe mbetet Historia e organizimit të Ushtrisë NÇ Shqiptare. Për këtë dëshmojnë përgatitja dhe mbrojtja e temës së doktoratës (viti 1989), që pasoi në vitin 1999 me Librin "Histori e Pashkruar", i cili u ribotua i plotësuar me të dhëna të reja të shumta në prill të vitit 2025.

Kësisoj mund të them se tërheqja dhe pëlqimi për këtë temë duket sikur nuk do të reshtë së më ngacmuari për të kërkuar e shkruar për të!

Si është procesi i përgatitjes së një libri historik me bazë arkivore, nga kërkimi deri te botimi?

Përgatitja e një libri historik-shkencor kalon nëpër një proces vërtet të gjatë, njëherësh edhe mjaft të ndërlikuar. Kjo ndodh sepse është një proces krijues i lidhur ngushtësisht me kërkimin, vjeljen e studimin e dokumenteve që vijnë kryesisht nga botime arkivore, por edhe muzeale, filmike, fotografike, si dhe nga shtypi i shkruar.

Në një projekt libri me karakter e përmbajtje historiko-shkencore, së pari është e nevojshme të përcaktohet qëllimi, që synohet të arrihet përmes kësaj vepre (ose libri).

Në vijim, hapi i dytë mjaft i rëndësishëm për këtë proces, pa dyshim që është përgatitja dhe pasja e një projekti paraprak ose fillestar të hapave që do të duhet të ndjekë autori për të zbatuar procesin e përgatitjes së librit (veprës). Ky projekt paraprak, i cili miratohet (bien në një mëndje), kur janë grup-autorë, zakonisht përmban disa elementë të domosdoshëm për nisjen e punës për të shkruar librin. Midis tyre janë:

- Qëllimi që duhet të arrihet përmes këtij studimi (libri);
- Autori ose grupi i autorëve;
- Struktura me pjesët, krerët (kapitujt), Parathënia dhe Hyrja;
- Aparati shkencor me Bibliografinë, faksimile të dokumenteve kryesore, fotografi, harta, pasqyra me të dhëna (statistika), skema etj.
- Në Projektin paraprak pjesë e rëndësishme e thelbësore për të shkruar një libër të kësaj natyre janë edhe lista e arkivave, dokumenteve të filmit dokumentar, historik, bibliotekave, muzeve-historikë, fototeka, kryesisht brenda, por dhe jashtë shtetit, në të cilat do të kryhen kërkime dhe përzgjedhje të dokumenteve që kanë lidhje me temën e librit që do të shkruhet.
- Pjesë e këtij projekti janë edhe intervistat me personazhe dhe veteranë të periudhave historike që përfshin dhe trajton libri përkatës.

Përgatitja dhe miratimi i këtij projekti mund të quhet i plotë dhe i përmbyllur me të gjithë përbërësit e tij sapo të jenë gjetur edhe financimet për fillimin dhe zbatimin e tij. Vetëm pas kësaj projekti mund të quhet i përmbushur dhe mund të nisë puna për realizimin e tij.

Kuptohet që, kohën më të madhe në këtë proces e zë puna për kërkimin dhe mbledhjen e të dhënave arkivore, i cili përbën bazën e materialit si dhe vlerësohet si i dorës së parë për një historik-shkencor. Nëpërmjet tyre gjenden dhe mblidhen të dhëna për ngjarje, dukuri, vende, personazhe dhe data e të dhëna të tjera, të cilat i shërbejnë shkrimit të librit.

Po ashtu, mblidhen të dhëna edhe nga arkivat e filmave dokumentarë që u përkasin periudhave që trajton libri, për të vijuar me të dhëna nga muzetë historikë, nga bibliotekat dhe shtypi i shkruar dhe botimet e studimet e reja, etj.

Të gjitha të dhënat e gjetura gjatë kërkimeve e studimeve të mësipërme, u nënshtrohen përzgjedhjes, ngjarjes e grupimit të tyre sipas kreve (kapitujve), çështjeve dhe nën-çështjeve që përfshin projekti i librit.

Më tej do të duhet të rishikohet dhe plotësohet e saktësohet projekti-paraprak, ashtu si dhe afatet e shkrimit, ilustrimit e redaktimit të librit, deri në kohën e dërgimit të tij për botim. Pas kësaj nis puna për të shkruar krerët dhe çështje e nën-çështje të librit historik-shkencor. Libri i përfunduar si dorë e parë, kur është vepër kolektive, i nënshtrohet një diskutimi në redaksinë e ngritur nga vetë autorët dhe ripunimit e plotësimit, sipas mendimeve e synimeve të dala në atë redaksi. Në rastin kur libri ka një autor të vetëm, atëherë ai mban peshën e shkrimit, të redaktimit e të plotësimit të atij libri. Vetëm pasi libri të kalojë në një redaktim të dyfishtë, shkencor e gjuhësor-letrar.

Ky është procesi apo rrugëkalimi që ndjek autori, i cili shkruan një libër historik me bazë dokumentacionin arkivor.

Si e vlerësoni bashkëpunimin me autorë të tjerë në veprat kolektive? A është e vështirë të ruhet një zë i unifikuar shkencor?

Bashkëpunimi i një grupi autorësh për të shkruar një libër apo vepër historike të natyrës kolektive, sigurisht është më i vështirë. Por, njëherësh, një ndërmarrje e tillë ka përparësi në pikëpamje të diskutimeve apo debatit për çështje të caktuara që trajtohen në këtë libër. Po ashtu, kjo ndërmarrje duket e lehtë sepse, në fund të fundit, çdo autor pjesëmarrës në bashkautorësi do të ulet për të shkruar pjesë, kreun apo çështjen e tij. Zakonisht vepra të tilla kolektive, me disa autorë, më së shumti janë studime institucionale, që u përkasin akademive shkencore, instituteve apo departamenteve me natyrë shkencore.

Por, sigurisht në një vepër të këtij lloji, vështirësia më e ndjeshme shfaqet në ruajtjen apo krijimin e një zëri apo toni të unifikuar, edhe pse ajo shkruhet nga disa autorë! Kjo vështirësi është e kuptueshme të shfaqet, sepse në përgatitjen e kësaj vepre marrin pjesë, janë në bashkautorësi, disa autorë. Sigurisht që, ata kanë karakteristikat e tyre dalluese në mënyrën e kërkimit dhe përzgjedhjes së të dhënave dokumentare apo të tjera, që janë të domosdoshme për një libër shkencor. Gjithashtu ata kanë mënyrën e tyre të interpretimit të të dhënave dokumentare, që dallohen për stilin e të shkruarit e të tjera dallime si këto. Pikërisht këtu, në këto dallime gjendet vështirësia, tek mungesa e unifikimit shkencor, por edhe letrar (gjuhësor) të librit (veprës).

Pikërisht, për të përafruar sa më shumë, mundësisht deri në unifikimin e pjesëve të shkruara prej secilit autor, procesi i përgatitjes së librit duhet të ndjekë një rrugë kalimi të ndryshëm nga librat e tjerë të karakterit shkencor, por me një autor të vetëm. Ky "rrugëkalim" përbëhet nga disa "ndalesa", të cilat, si të thuash, synojnë të bëjnë unifikimin e materialit shkencor të shkruar nga autorët e këtij libri, veç e veç.

Pikërisht në këtë ecuri bashkautorët, ose një redaksi e krijuar prej tyre, nëpërmjet diskutimit konstruktiv bën së pari identifikimin dhe përdorimin e dokumenteve të përdorura në pjesët, krerët apo çështje të ndryshme të librit. Pas kësaj, së dyti bëhet rishikimi, redaktimi, plotësimi e saktësimi i strukturës dhe i krejt lëndës së librit. Së treti, libri duhet t'i nënshtrohet një redaktimi të plotë shkencor letrar-gjuhësor, për të qenë sa më i qartë dhe shprehës për lexuesit e studiuesit e tij.

Pas kësaj pune të gjatë dhe këtyre hapave, besoj se është e kuptueshme pse është e vështirë të përgatitet e të publikohet një vepër kolektive shkencore, në raport me librat e shkruar nga një autor i vetëm.

Këto vështirësi dhe raportin e dallimit mes veprës shkencore kolektive me atë individuale, mund t'i ilustroj me përvojën personale dhe të kolegëve të mi. Ndër ta kanë qenë librat me bashkautorësi si "Historia e Artit Ushtarak të popullit shqiptar gjatë LANÇSH, 1939-1944", (Botim i Akademisë Ushtarake, Tiranë 1987); "Histori Lidershipi", (Tiranë, 2017); "Historia e Ushtrisë Shqiptare, 1912-1939"; (Tiranë, 2023), e libra të tjerë.

Ndër më të vështirët ka qenë punimi i veprës "Historia e Artit Ushtarak të popullit shqiptar gjatë LANÇSH, 1939-1944", me 6 bashkautorë, ku pasi u shkruan krerët përkatës nga secili prej autorëve, ato iu nënshtruan diskutimit e redaktimit në redaksinë e librit, i cili zgjati afro katër-pesë muaj. Pas redaktimit gjuhësor, libri u dërgua për botim dhe, me vënien në qarkullim vepra u mirëprit nga studentët, akademistët ushtarakë dhe lexues të tjerë, si dhe nga vetë qarqet shkencore të ushtrisë e më gjerë. Vepra duket si e shkruar nga një autor, sepse është e unifikuar në pikëpamje shkencore e gjuhësore.

Cila është vepra që ende nuk e keni përfunduar, por e konsideroni të rëndësishme për trashëgiminë historike shqiptare?

Në mendjen, në planet dhe në duart e çdo studiuesi ose krijuesi, ashtu si dhe për mua dhe kolegët e bashkëpunëtorët e mi, besoj se dhe për të gjithë studiuesit e tjerë të çdo fushe ka ndonjë punim ose studim mbi të cilin punon. Kështu ndodh edhe me mua, që sapo përfundoj një libër apo një shkrim, nis një tjetër, idenë e të cilit e kam përpunuar në mendje, madje projektin e tij e kam skicuar në letër!

Kësisoj, së bashku me një prej bashkëpunëtorëve të mi, të hershëm, Dr. Asllan Zemanin, pasi përfunduam dhe publikuam librin e Parë të Historisë së Ushtrisë Shqiptare, 1912-1939, krahas punëve të tjera, nisëm të skiconim projektin e studimit për të shkruar Historinë e Ushtrisë Shqiptare të viteve 1939 deri në nëntorin e vitit 1944, me çlirimin e Shqipërisë nga pushtuesit e huaj fashistë.

Sipas mendimit dhe vlerësimit tonë të qartë, përgatitja dhe publikimi i këtij libri, përbën një shërbim në plotësimin e historisë së panjohur të Ushtrisë Shqiptare plot ndërlikime gjatë viteve të vështirë të pushtimit të Shqipërisë.

Por, sigurisht, që të përmbyllet projekti kushtuar "Historisë së Popullit Shqiptar" në tre vëllime që, siç kemi përmendur më parë, rrok periudhën 4 Dhjetor 1912 deri më 1990, mungon një pjesë shumë e rëndësishme e saj, vëllimi i Tretë. Ky vëllim përmbyllës i këtij projekti që përfshin dhe trajton harkun e gjatë kohor 1945-1990, prej përfundimit të Luftës për çlirimin e vendit nga pushtuesit e huaj deri në rënien e sistemit monist në Shqipëri, në vitin 1990. Kjo ka qenë një periudhë jo vetëm e gjatë kohore, por edhe e mbushur me plot veçori e dallime në përqasje me periudhat e tjera historike, përmes të cilave ka kaluar e vepruar edhe Ushtria Shqiptare.

Prandaj për t'iu përgjigjur pyetjes tuaj, mund të them me bindje se kjo është vepra më e rëndësishme për trashëgiminë historike shqiptare. Kjo do të thotë se brezat e sotëm por edhe ata të rinj do të kenë një libër të cilit t'i referohen për të mësuar se cila ka qenë Ushtria Shqiptare, cila ka qenë ecuria e saj nga krijimi deri në fundin e viteve tetëdhjetë të Shek. XX. Kësaj i thonë të përkujdesesh për trashëgiminë e popullit edhe në fushën ushtarake, për ruajtjen, njohjen dhe vijimësinë e saj. Këtu qëndron, më së shumti, rëndësia e kësaj vepre, e cila është në përgatitje e sipër, por që kërkon mbështetje nga institucionet e Mbrojtjes e të studimeve shkencore të saj, por dhe më gjerë.

Cili ka qenë bashkëpunimi ndërkombëtar më sfidues dhe cilat përfitime konkrete solli në fushën tuaj?

Bashkëpunimi në planin ndërkombëtar, në përgjithësi dhe posaçërisht në fushën e studimeve shkencore për Historinë Ushtarake, mbart rëndësi të veçantë. Kjo për dy arsye kryesore: së pari, sepse këto bashkëpunime sjellin njëherësh njohje, këmbim e përfitim përvoje dhe, së dyti, bën të njohur ndërkombëtarisht personalitetet e studimeve edhe në fushën e studimeve shkencore dhe akademike, siç është Historia Ushtarake.

Prandaj bashkëpunimi në hapësirën ndërkombëtare është sa e rëndësishme aq edhe sfiduese. Tek ne nuk kanë qenë të shumta, por as nuk kanë munguar këto lloj bashkëpunimesh, dhe në fushën e lëvrimit të Historisë Ushtarake, që duhet ditur se është një nga të pasurat edhe në Shqipëri.

Që aty nga fillimi i viteve nëntëdhjetë të shekullit të shkuar, por veçanërisht nga fillimi i viteve dymijë, departamenti i Historisë Ushtarake, i vetmi në vend, në përbërje të Akademisë së Shtabit të Përgjithshëm (siç u emërtua në vitin 1994 ish-Akademia Ushtarake), nisi krijimi i lidhjeve e më tej i marrëveshjeve me institucione të vendeve anëtare të NATO-s, të cilat merreshin me studimin e Historisë Ushtarake. Ndër to po kujtoj mes tyre marrëveshjet me Institutin e Historisë Ushtarake të Gjermanisë, me qendër në Potsdam, vizitat e ndërsjella për botime të përbashkëta për tema të ndryshme, si Lufta e Parë dhe e Dytë Botërore (194-1914 dhe 1939-1945).

Në vijim, pasojnë kërkime në Arkivin e Shtabit të Përgjithshëm dhe në zyrën e Historisë së këtij shtabi, në Romë të Italisë. Kjo u ndoq nga vizita me karakter studimor në Muzeun Ushtarak të Stambollit, në Turqi, apo edhe ai në Muzeun e Historisë Ushtarake, në Drezden të Gjermanisë, me Ambasadën e Austrisë në Tiranë, me Institutin e Historisë së Kosovës.

Këto vizita prodhuan marrëveshje për kërkime për dokumente në arkivat e vendeve në marrëveshje; për krijimin e lidhjeve dhe marrëveshjeve me institucione të ngjashme për studime shkencore dhe mësimdhënie në fushën e Historisë Ushtarake; këmbim përvojash për studime të temave të ndryshme në këtë fushë, etj.

Sigurisht, bashkëpunimi në plan ndërkombëtar mbetet sa i rëndësishëm aq edhe sfidues, si në çdo fushë edhe në atë të studimeve të Historisë Ushtarake.

Sipas përvojës, jo dhe aq të pasur në këtë lloj bashkëpunimi, sfidat tona më të pranishme e të dukshme në njohjen dhe përdorimin e gjuhës përkatëse të vendeve me të cilat realizohet bashkëpunimi studimor e akademik-shkencor, gjetja e burimeve financiare për mbështetjen e këtyre udhëtimeve, akomodimeve dhe studimeve të fushës sonë.

Me gjithë vështirësitë dhe sfidat e shumta, bashkëpunimi ndërkombëtar është i domosdoshëm edhe për studimet e Historisë Ushtarake. Kjo, sepse përmes këtij bashkëpunimi veprat dhe studimet në këtë fushë do të mund të bëhen të njohura edhe në vende të tjera evropiane e më gjerë. Por, kjo ndërmarrje pa dyshim kërkon mbështetje nga ana e institucioneve përkatëse dhe sponsorëve vendas ose të huaj. Dhe sigurisht kjo është një ndërmarrje me vlera shkencore por edhe për vendin, që i përket më së shumti së sotmes e, sidomos të ardhmes.

(Vijon në numrin e ardhshëm...)

NË BRUKSEL, MUZIKA U BË URË MES SHQIPTARËVE DHE MESAZHIT TË SHËN TEREZËS

Ansambli i Harqeve i Orkestrës Simfonike të Forcave të Armatosura, nën drejtimin e dirigjentit Fabjol Aliaj dhe me pjesëmarrjen e sopranos Markela Jakaj, solli në Kishën Notre-Dame de Laeken një mbrëmje të veçantë kushtuar Shën Terezës, në 10-vjetorin e shenjtërimit të saj



Bruksel: Në një prej hapësirave më të njohura të kultit në Bruksel, aty ku muzika dhe heshtja bashkëjetojnë natyrshëm, tingujt e një ansambli shqiptar sollën një mbrëmje të veçantë kushtuar një figure që i përket jo vetëm kujtesës shqiptare, por edhe trashëgimisë shpirtërore botërore.

Më 4 nëntor, në orën 19:30, **Kisha Notre-Dame de Laeken** u kthye në skenën e një koncerti në nderim të **Shën Terezës**, në kuadër të 10-vjetorit të shenjtërimit të saj. Përmes muzikës, artistët shqiptarë përcollën një mesazh që tejkaloi kufijtë e një koncerti artistik: kujtesën, përkatësinë, dashurinë për njerëzit dhe dimensionin universal të figurës së Nënë Terezës.

Në këtë mbrëmje të veçantë, **Ansambli i Harqeve i Orkestrës Simfonike të Forcave të Armatosura**, nën drejtimin e dirigjentit **Fabjol Aliaj**, u paraqit përpara publikut shqiptar në Bruksel me një repertor të zgjedhur, ku tradita e madhe e muzikës klasike u ndërthur me krijimtarinë e autorëve shqiptarë.

Prania e sopranos **Markela Jakaj** i dha koncertit një dimension të veçantë vokal dhe emocional. Zëri i saj, i ndërthurur me tingujt e harqeve, krijoi një atmosferë të përshtatshme për natyrën e veçantë të mbrëmjes: një homazh për një grua që e ndërtoi jetën mbi përkushtimin ndaj njeriut, mbi dashurinë dhe shërbimin.

Kur muzika bëhet kujtesë

Nuk ishte rastësi që kjo mbrëmje u zhvillua pikërisht në një kishë. Hapësira e Notre-Dame de Laeken, me karakterin e saj monumental dhe shpirtëror, krijoi një sfond ku çdo tingull merrte një tjetër peshë. Muzika nuk ishte vetëm interpretim. Ajo u shndërrua në një formë kujtese dhe reflektimi.

Në këtë atmosferë, repertori i koncertit solli kryevepra të muzikës klasike, duke përfshirë vepra të **Antonio Vivaldit** dhe **Johann Sebastian Bach**, dy emra të mëdhenj të traditës muzikore evropiane. Përballë kësaj trashëgimie të njohur ndërkombëtarisht, tingëlloi edhe muzika shqiptare, përmes krijimtarisë së kompozitorëve **Avni Mula, Prenk Jakova** dhe autorëve të tjerë. Kjo ndërthurje i dha koncertit një identitet të veçantë. Ishte një dialog mes traditës evropiane dhe asaj shqiptare, mes muzikës së njohur të skenave botërore dhe melodive që mbartin brenda tyre kujtesën, emocionin dhe identitetin shqiptar.

Pikërisht këtu qëndroi edhe një prej vlerave të kësaj mbrëmjeje: **Shqipëria u prezantua përmes kulturës, përmes artit dhe përmes muzikës**.

Dhe në një qytet si Brukseli, ku bashkëjetojnë kultura, gjuhë dhe tradita të ndryshme, një koncert i tillë merr një kuptim edhe më të gjerë. Ai bëhet një mundësi për të treguar se identiteti kombëtar nuk përcillet vetëm përmes fjalës, por edhe përmes artit.



Një homazh për një figurë universale

Shën Tereza mbetet një prej figurave më të njohura shqiptare në botë. E lindur në Shkup, me origjinë shqiptare, ajo e lidhi jetën e saj me shërbimin ndaj njerëzve në nevojë dhe u shndërrua në një simbol universal të mëshirës, përkushtimit dhe humanizmit.

Dhjetë vjet pas shenjtërimit të saj, figura e Shën Terezës vazhdon të jetë e pranishme në kujtesën e miliona njerëzve. Për shqiptarët, ajo mbetet gjithashtu një pikë e fortë e identitetit dhe krenarisë kombëtare.

Për këtë arsye, një mbrëmje kushtuar Nënë Terezës nuk mund të ishte vetëm një aktivitet artistik. Ajo ishte edhe një moment bashkimi për komunitetin shqiptar në Bruksel.

Në sallën e koncertit, publiku shqiptar u bë pjesë e kësaj përvoje muzikore, duke e ndjekur interpretimin e Ansamblit të Harqeve të Orkestrës Simfonike të Forcave të Armatosura dhe të artistes Markela Jakaj.

Tingujt e Vivaldit dhe Bahut krijuan lidhjen me traditën e madhe klasike evropiane, ndërsa veprat e autorëve shqiptarë sollën në këtë hapësirë një tjetër dimension të identitetit tonë kulturor.

Kështu, repertori u shndërrua në një udhëtim muzikor



nga Evropa te Shqipëria, nga tradita universale te kujtesa kombëtare dhe nga arti te mesazhi shpirtëror i mbrëmjes.

Forcat e Armatosura edhe përmes kulturës

Pjesëmarrja e **Orkestrës Simfonike të Forcave të Armatosura** në këtë aktivitet është gjithashtu një dëshmi e dimensionit të gjerë që mbart veprimtaria e Forcave të Armatosura. Përtej misionit të tyre të drejtpërdrejtë në mbrojtjen dhe sigurinë e vendit, strukturat e Forcave të Armatosura kanë edhe një rol të rëndësishëm në përfaqësimin e vlerave kombëtare përmes kulturës dhe artit.

Orkestra Simfonike e Forcave të Armatosura është një prej formacioneve që e përcjell këtë dimension. Nëpërmjet muzikës, ajo përfaqëson Shqipërinë në veprimtari të ndryshme, duke e bërë artin një tjetër mënyrë komunikimi dhe përfaqësimi.

Në koncertin e Brukselit, kjo prani mori një kuptim të veçantë. Uniforma ushtarake u shoqërua me instrumentet muzikore, ndërsa disiplina e orkestrës u bashkua me ndjeshmërinë artistike. Në dirigjimin e Fabjol Aliajt, ansambli solli një interpretim që bashkoi profesionalizmin muzikor me solemnitetin e një mbrëmjeje kushtuar një figure të shenjtë.

Shqipëria që tingëllon përtej kufijve

Një koncert i tillë ka vlerë edhe për komunitetin shqiptar jashtë vendit. Në një kohë kur shqiptarët janë të pranishëm në shumë vende të botës, ruajtja e lidhjes me kulturën dhe traditën kombëtare bëhet gjithnjë e më e rëndësishme. Në Bruksel, kjo lidhje u krijua përmes muzikës.

Publiku shqiptar pati mundësinë të dëgjonte në një hapësirë prestigjioze një repertor që bashkoi autorë të mëdhenj të muzikës klasike me emra të rëndësishëm të muzikës shqiptare. Ishte një mbrëmje ku tingujt nuk kishin nevojë për përkthim.

Muzika e bëri të drejtpërdrejtë komunikimin.

Ajo solli në vëmendje kujtesën e një prej figurave më të mëdha të botës shqiptare dhe njëkohësisht dëshmoi se kultura shqiptare mund të jetë një mënyrë e fuqishme për të komunikuar me botën.

Mirënjohje për bashkëpunimin

Realizimi i kësaj mbrëmjeje u bë i mundur edhe falë bashkëpunimit dhe mbështetjes së institucioneve dhe komunitetit shqiptar në Bruksel.

Një mirënjohje e veçantë shkon për **Bashkësinë Katolike Shqiptare në Bruksel** dhe **Ambasadën e Republikës së Shqipërisë në Bruksel**, për bashkëpunimin dhe kontributin në realizimin e këtij aktiviteti.

Bashkëpunime të tilla dëshmojnë rëndësinë e krijimit të hapësirave ku komuniteti shqiptar jashtë vendit mund të takohet me kulturën, historinë dhe vlerat e vendit të origjinës. Dhe këtë herë, takimi u bë nëpërmjet muzikës. Në përfundim të mbrëmjes, ajo që mbeti nuk ishte vetëm jehona e tingujve të Vivaldit, Bahut, Avni Mulës apo Prenk Jakovës. Mbeti edhe mesazhi i një figure që e ka vendosur dashurinë për njeriun në qendër të jetës së saj.

Shën Tereza u nderua përmes muzikës, ndërsa Shqipëria u përfaqësua përmes artistëve të saj.

Në Kishën Notre-Dame de Laeken, në zemër të Brukselit, një orkestër shqiptare solli tingujt e vendit të saj dhe një komunitet shqiptar u bashkua rreth një figure që prej dekadash kapërcen kufijtë e kombit, fesë dhe kulturës.

Ishte një mbrëmje ku **muzika u bë kujtesë, arti u bë përfaqësim dhe Shën Tereza u bë pika e takimit mes shpirtërores dhe identitetit shqiptar**.

BESNIK KURSHUMI,
PROFESORI QË NDËRTOI MË SHUMË SE NJË FUSHË SPORTIVE

Një jetë në shërbim të edukimit, përgatitjes fizike dhe brezave të Skënderbegasve - Kujtimi i një mësuesi që e deshi profesionin dhe nxënësit si fëmijët e vet

LEONARD MUSOLLARI

Në historinë e çdo institucioni ka njerëz që nuk maten me vitet e shërbimit apo me detyrat që kanë mbajtur, por me gjurmën që kanë lënë te njerëzit dhe me vlerat që kanë përcjellë. Të tillë janë edukatorët e vërtetë, të cilët nuk mjaftohen me transmetimin e dijes, por bëhen pjesë e formimit njerëzor e profesional të brezave. Ata e shohin profesionin si një mision, të cilin e përmbushin me përkushtim, ndershmëri dhe dashuri, duke dhënë nga vetja shumë më tepër sesa ua kërkon detyra.

I tillë ishte profesor Besnik Kurshumi.



Lajmi për ndarjen e tij nga jeta, më 30 tetor 2026, pas një sëmundjeje të rëndë, më preku thellë. Bashkë me dhimbjen, më riktheu në kujtesë vitet e mia në Shkollën e Mesme Ushtarake **"Skënderbej"**, periudhën 1983–1987, një pjesë e rëndësishme e jetës sime, ku krahas dijeve, disiplinës dhe formimit ushtarak, mësuam edhe vlerën e miqësisë, të përgjegjësisë dhe të përkushtimit ndaj detyrës.

Në kujtesën time, mes shumë pedagogëve dhe oficerëve që ndikuan në formimin tonë, profesor Besniku zë një vend të veçantë. Ai ishte mësuesi i Edukimit Fizik, pedagogu kërkues, metodisti i përkushtuar dhe njeriu i palodhur i punës. Por, mbi të gjitha, ishte një njeri që nuk e ndante profesionin nga dashuria për nxënësit. Na shihte si fëmijët e vet dhe këtë nuk e shprehte me fjalë të mëdha, por me veprime konkrete, me kujdesin e përditshëm dhe me gatishmërinë për të bërë gjithçka që ishte në të mirë të formimit tonë.

Sot, pas kaq shumë vitesh, kur e shoh jetën edhe përmes përvojës sime si ushtarak karriere, e kuptoj shumë më mirë se çfarë përfaqësonte ai njeri për ne. Atëherë e njihnim si profesorin që na drejtonte në stërvitje, që kërkonte përgatitje dhe disiplinë. Sot e kujtoj si një edukator të rrallë, i cili nuk e kufizonte përgjegjësinë te ora mësimore, por e shtrinte atë në çdo gjë që lidhej me mirëqenien, përgatitjen dhe të ardhmen tonë.

Profesori që ndërtonte me duart e veta

Një nga kujtimet më të forta dhe më domethënëse që ruaj për profesor Besnikun lidhet me ambientet sportive të shkollës. Ai ishte njeriu që punonte vetë për ndërtimin, rregullimin dhe mirëmbajtjen e tyre. Nuk priste që dikush tjetër të ndërhynte, nuk mjaftohej me udhëzime apo me kërkesa drejtuar të tjerëve. Kur shihte se duhej bërë diçka, e merrte vetë përsipër.

E kujtoj pasditeve, duke punuar për fushën sportive, duke vendosur gurët e shtrimit njëri pas tjetrit, duke rregulluar hapësirat dhe duke përgatitur vendin ku ne do të zhvillonim stërvitjen. Punonte paradite e pasdite, pa e ndier lodhjen. Edhe punimet me hekur, saldimet e paraleleve dhe përgatitjen e pajisjeve të tjera sportive i kryente vetë. Ishte i gjithanshëm, i kudondodhur dhe, mbi të gjitha, njeri i punës.

Gjatë viteve 1983–1987, kur unë studioja në Shkollën "Skënderbej", falë punës dhe pasionit të tij u krijua një ambient i mirëfilltë sportiv, me kënde lojërash dhe me elementet e nevojshme për kalitjen fizike e përgatitjen fiziko-ushtarake të nxënësve.

Për ne, ato ambiente ishin pjesë e përditshmërisë. Aty vraponim, stërviteshim, provonim forcat dhe mësonim të përballonim lodhjen. Për profesor Besnikun, ato ishin një përgjegjësi që duhej përmbushur me përkushtim. Ai e kuptonte se përgatitja fizike e një nxënësi që synonte të bëhej ushtarak kërkonte jo vetëm program mësimor dhe metodikë, por edhe kushte të përshtatshme, mjete dhe hapësira ku të zhvilloheshin aftësitë e tij.

Ndoshta në atë kohë nuk e kuptonim plotësisht sa shumë punë fshihej pas çdo pajisjeje, çdo elementi sportiv dhe çdo hapësire të rregulluar. Ne shkonim për t'u stërvitur, për të vrapuar, për të luajtur e për të përmirësuar aftësitë tona. Por pas gjithë kësaj qëndronte puna e një njeriu që kishte vendosur të jepte më shumë sesa kërkonte detyra e tij.

Sot, kur e kujtoj, më duket se ajo fushë sportive ishte një pasqyrë e karakterit të tij. E kishte ndërtuar me durim, me mund dhe me duart e veta, ashtu siç përpiqej të ndërtonte te ne qëndrueshmërinë, disiplinën dhe vullnetin.

Për dikë që nuk e ka jetuar atë kohë, vendosja e gurëve, saldimi i paraleleve apo rregullimi i një këndi sportiv mund të duken punë të zakonshme. Por në kujtesën time këto veprime janë bërë simbol i një përkushtimi të jashtëzakonshëm. Profesor Besniku nuk po rregullonte vetëm një fushë. Ai po krijonte kushtet ku do të formoheshin fizikisht dhe shpirtërisht breza të tërë të rinjsh.

Një pedagog që e jetonte profesionin si mision

Besnik Kurshumi ishte atlet i talentuar dhe njeri i apasionuar pas sportit e përgatitjes fizike. Pas përfundimit të studimeve në Institutin e Edukimit Fizik, erdhi pedagog në Shkollën **"Skënderbej",** ku ushtroi me pasion profesionin e tij të dashur. Më pas mori edhe përgjegjësinë e shefit të përgatitjes fizike.



Ai ishte metodist, kërkues dhe këmbëngulës. E njihte mirë rëndësinë e përgatitjes fizike në formimin e një ushtaraku. Për të, sporti nuk ishte vetëm aktivitet apo garë. Ishte një mënyrë për të formuar vullnetin, për të zhvilluar qëndrueshmërinë, për të mësuar disiplinën dhe për të përballuar vështirësitë.

Në mjedisin e Shkollës **"Skënderbej",** ku disiplina, organizimi dhe përgatitja ishin pjesë e pandarë e jetës sonë, ai kishte një rol të veçantë. Na kërkonte të jepnim maksimumin, të mos shmangnim vështirësitë dhe të mos dorëzoheshim përpara lodhjes. Por, përtej kërkesave profesionale, ai shihte te secili prej nesh një të ri që po rritej, po formohej dhe që kishte nevojë për kujdes e mbështetje.

Kjo ishte një nga cilësitë që e bënin të dashur dhe të respektuar. Ai e lidhte autoritetin e mësuesit me kujdesin njerëzor. Ishte i urtë, i komunikueshëm, i dashur dhe i afërt me të gjithë. Respektonte nxënësit, kolegët, oficerët, punonjësit dhe eprorët. Nuk e përdorte autoritetin për të krijuar largësi, por për të ndërtuar respekt.

Për ne, kjo kishte shumë rëndësi. Në atë mjedis ku dita ishte e organizuar dhe kërkesat ishin të vazhdueshme, prania e një mësuesi që të ndiqte me vëmendje dhe interesohej për formimin tënd ishte një mbështetje e çmuar.

Ai ishte nga ata njerëz që të mësonin edhe pa folur. Mjaftonte ta shihje duke punuar, për të kuptuar se përgjegjësia nuk është vetëm të kërkosh nga të tjerët, por të japësh edhe vetë. Nuk mjafton të thuash se e do profesionin; duhet ta dëshmosh këtë çdo ditë.

Përkushtimi i tij shkoi përtej mureve të shkollës "Skënderbej"

Puna e profesor Besnikut nuk u kufizua vetëm në shkollën ku ne studiuam. Të njëjtën frymë përkushtimi ai e përcolli edhe në krijimin e ambienteve sportive në Shkollën e Bashkuar. Edhe atje u angazhua me pasion, duke dhënë kontributin e tij për përmirësimin e kushteve të përgatitjes fizike.

Kjo dëshmon se ai nuk punonte thjesht për të përmbushur një detyrë në një institucion të caktuar. Ai e kishte përvetësuar si bindje se përgatitja fizike e ushtarakëve kërkon ambiente, mjete, metodikë dhe, mbi të gjitha, njerëz të përkushtuar.

Në jetën ushtarake, shumë gjëra maten me rezultate, me detyra të përmbushura dhe me përgjegjësi të realizuara. Por ka edhe kontribute që nuk regjistrohen në raporte e dokumente. Janë kontributet e njerëzve që, larg vëmendjes, ndërtojnë, përmirësojnë dhe krijojnë kushte për të tjerët. Janë ata që nuk kërkojnë vlerësime për çdo punë që bëjnë, sepse kënaqësinë më të madhe e gjejnë te rezultati dhe te dobia që u sjellin të tjerëve.

Profesor Besniku ishte pikërisht njëri prej tyre.

Ai nuk kërkonte duartrokitje për punën që bënte. Nuk kishte nevojë të tregonte se sa kishte punuar, sepse puna e tij dukej. E tregonin ambientet sportive, pajisjet që kishte përgatitur, brezat që kishte edukuar dhe respekti që ruanin për të ish-nxënësit e kolegët.

Njeriu që e kishte emrin Besnik dhe e justifikoi atë me jetën e tij

Përtej profesionistit dhe punëtorit të palodhur, Besnik Kurshumi do të kujtohet për cilësitë e tij njerëzore. Ishte i sinqertë, i ndershëm, i urtë dhe gjithmonë i gatshëm të ndihmonte këdo që i drejtohej. Rrallë mund të gjeje një njeri kaq punëtor e këmbëngulës, që të mos e ndiente lodhjen dhe që të mos e kursente veten kur bëhej fjalë për një punë të dobishme.

Në kujtimet e ish-Skënderbegasve, ai nuk shfaqet vetëm si pedagogu i Edukimit Fizik, por si njeriu që kujdesej për ta edhe përtej detyrës. Ishte një figurë e afërt, që dinte të komunikonte me të gjithë dhe të krijonte marrëdhënie të mbështetura në respekt e mirëkuptim.

Ka diçka domethënëse edhe te emri i tij. Kur mendoj për profesorin tonë, më duket sikur ai emër përputhej plotësisht me njeriun që kishim njohur. Besnik ndaj profesionit, ndaj detyrës, ndaj kolegëve dhe ndaj nxënësve të tij.

Në ditët e fundit, kur lajmi për ndarjen e tij nga jeta u përhap mes ish-Skënderbegasve, shumë prej nesh ndien nevojën të shprehnin dhimbjen dhe mirënjohjen. Mesazhet e ngushëllimit dhe kujtimet e ish-nxënësve, pedagogëve e kolegëve dëshmojnë se ai kishte lënë një gjurmë të thellë te njerëzit. Secili ruan një kujtim të vetin, një fjalë, një veprim, një moment nga vitet e kaluara në shkollë.

Por në të gjitha këto kujtime përsëritet e njëjta ide: profesor Besniku ishte njeriu i punës, i përkushtimit dhe i ndershmërisë. Një njeri që nuk e ndante fjalën nga vepra.

Mësuesit e vërtetë nuk largohen nga kujtesa e nxënësve

Vitet e shkollës kanë kaluar. Secili prej nesh ka ndjekur rrugën e vet, ka ndërtuar familjen, karrierën dhe jetën e tij, ka përballuar sfida dhe ka marrë përgjegjësi të ndryshme. Por vitet e "Skënderbeut" mbeten pjesë e pandashme e identitetit tonë.

Si ish-nxënës dhe sot ushtarak karriere, e kuptoj më mirë se sa i rëndësishëm është roli i edukatorit në formimin e një ushtaraku. Një ushtarak nuk formohet vetëm përmes njohurive teorike dhe aftësive profesionale. Ai formohet edhe përmes disiplinës, qëndrueshmërisë fizike, vullnetit, respektit për detyrën dhe shembullit të njerëzve që e udhëheqin në vitet e para të formimit.

Profesor Besnik Kurshumi ishte një prej atyre njerëzve që kontribuoi në këtë proces. Ai nuk na mësoi vetëm si të stërviteshim, si të përmirësonim aftësitë fizike apo si të përballonim një ngarkesë. Na tregoi, përmes jetës së vet, se puna duhet bërë me ndërgjegje, se përgjegjësia nuk përfundon aty ku mbaron detyra dhe se dashuria për profesionin matet me atë që jep nga vetja.

Në historinë e një institucioni si Shkolla "Skënderbej" ka shumë emra që meritojnë të kujtohen. Disa njihen për drejtimin, disa për mësimdhënien, disa për arritjet profesionale. Por ka edhe njerëz që, pa bërë zhurmë, kanë lënë pas vepra konkrete dhe një trashëgimi njerëzore që nuk matet me tituj apo pozicione.

Besnik Kurshumi ishte një prej tyre.

Ndarja e tij nga jeta është një humbje e madhe për familjen, të afërmit, miqtë dhe të gjithë ata që patën fatin ta njihnin. Është një dhimbje e veçantë për komunitetin e Skënderbegasve, që humbi një nga pedagogët e tij të dashur e të respektuar.

Por një edukator i vërtetë nuk largohet plotësisht. Ai mbetet te nxënësit që ka formuar, te vlerat që ka përcjellë, te puna që ka lënë pas dhe te kujtimet që nuk i tret koha.

Sot, kur kthehem me mendje në vitet 1983–1987, më shfaqet përsëri ajo fushë sportive dhe figura e profesor Besnikut duke punuar. Më duket sikur e shoh duke vendosur gurët, duke përgatitur pajisjet, duke rregulluar një hapësirë apo duke kontrolluar nëse gjithçka ishte gati për stërvitjen e ditës tjetër. Atëherë nuk e kuptonim plotësisht domethënien e atij kujdesi. Sot e kuptojmë. Ai po ndërtonte më shumë se një fushë sportive. Po krijonte kushte për formimin e brezave, po na jepte një shembull pune dhe përgjegjësie, po na mësonte se njeriu duhet të lërë pas diçka të dobishme për të tjerët.

Dhe kjo është trashëgimia e tij më e çmuar.

Lamtumirë, profesor Besnik!

Në emrin tim dhe të shumë ish-Skënderbegasve, ju shpreh mirënjohjen dhe respektin më të thellë për gjithçka që bëtë për ne, për shkollën dhe për brezat që edukuat.

Ngushëllimet më të sinqerta familjes, të afërmve, miqve dhe të gjithë atyre që ndajnë dhimbjen e kësaj humbjeje.

Ju nuk ndërtuat vetëm fusha sportive. Ndërtuat kujtime, formuat karaktere dhe mbollët vlera që do të vazhdojnë të jetojnë te brezat e Skënderbegasve.

Puna juaj mbeti. Shembulli juaj do të jetojë. Emri juaj nuk do të harrohet!

ZAIM KUÇI, PILOTI DHE DIPLOMATI USHTARAK QË E KTHEU PËRVOJËN NË UNIFORMË NË KONTRIBUT PËR SHQIPËRINË

Njerëzit që i shërbejnë atdheut meritojnë të mbeten në kujtesën e tij

Përgjatë viteve, shtypi ushtarak shqiptar, përmes revistës "Mbrojtja" dhe gazetës "Ushtria", ka pasur misionin dhe përgjegjësinë të pasqyrojë veprimtarinë, përkushtimin dhe arritjet e burrave dhe grave që kanë zgjedhur uniformën si rrugë shërbimi ndaj vendit. Në faqet tona kanë gjetur vend historia e tyre, përvoja profesionale, sakrificat, përgjegjësitë dhe kontributet e shumë brezave ushtarakësh, të cilët në kohë të ndryshme kanë përfaqësuar dinjitetin, profesionalizmin dhe vlerat e Forcave të Armatosura. Por misioni i shtypit ushtarak nuk përfundon vetëm me pasqyrimin e veprimtarisë së përditshme të strukturave dhe trupave. Ai përfshin edhe detyrimin për të evidentuar personalitetet, karrierat dhe arritjet që e kapërcejnë kufirin e një detyre apo funksioni, duke u bërë pjesë e historisë së përfaqësimit të Shqipërisë në arenën ndërkombëtare.

Në këtë këndvështrim vjen edhe portreti i kolonelit në rezervë Zaim Kuçi, i sjellë nga bashkëkohësi dhe kolegu i tij, Petraq Koroveshi. Një rrëfim që nis nga një vlerësim i rëndësishëm i Republikës Franceze, por që shkon përtej ceremonisë së dekorimit, duke ndriçuar një rrugëtim të gjatë profesional, nga aviacioni ushtarak te strategjia e mbrojtjes, diplomacia ushtarake dhe kontributi në median shqiptare e evropiane.

Për redaksinë tonë, ky shkrim është një mundësi për të rikthyer në vëmendje një profil që meriton të njihet, por edhe për të përcjellë një mesazh më të gjerë: përvoja e njerëzve që kanë shërbyer me përkushtim në uniformë është një pasuri që duhet dokumentuar, vlerësuar dhe transmetuar te brezat e rinj.

Sepse pas çdo karriere ushtarake qëndrojnë vite pune, dije, disiplinë dhe përgjegjësi. Dhe kur ky shërbim merr vlerësim edhe në institucione ndërkombëtare, ai bëhet një arsye më shumë për ta njohur dhe për ta bërë pjesë të kujtesës sonë të përbashkët.



PETRAQ KOROVESHI

Një karrierë mes aviacionit, strategjisë së mbrojtjes dhe diplomacisë ushtarake

Një emër që, përmes angazhimit profesional, analizave dhe botimeve, ka përcjellë imazhin e Shqipërisë në institucionet dhe qarqet strategjike evropiane

Çfarë më shtyu të shkruaj për kolonel Zaim Kuçin?

Pak kohë më parë, duke shfletuar faqen zyrtare të Ambasadës së Francës në Tiranë, u njoha me një ceremoni të veçantë, gjatë së cilës Shkëlqesia e Saj, ambasadorja e Francës, znj. Christine Moro, i dorëzoi kolonelit në rezervë Zaim Kuçi medaljen **"Oficer i Urdhrit Kombëtar të Meritës"**, të akorduar nga Presidenti i Republikës Franceze.

Ky lajm më tërhoqi menjëherë vëmendjen. Nuk bëhej fjalë thjesht për një dekoratë të dhënë një ushtaraku shqiptar, por për një vlerësim të rëndësishëm të një karriere, të një kontributi profesional dhe të një përfaqësimi dinjitoz të vendit tonë në një prej mjediseve më të rëndësishme të diplomacisë dhe sigurisë evropiane.

Vlerësimi i dhënë nga pala franceze dëshmon kujdesin dhe vëmendjen e treguar nga institucionet e mbrojtjes së Francës ndaj kontributit të kolonel Kuçit. Nga informacionet që munda të mbledh, mësova se në Francë janë të akredituar më shumë se 200 diplomatë ushtarakë nga shtete të ndryshme. Në këtë mjedis të gjerë përfaqësuesish, përzgjedhja dhe nderimi i një oficeri shqiptar përbëjnë një arritje që meriton vëmendje të veçantë.

Të jesh i vlerësuar në një hapësirë të tillë ndërkombëtare, ku përfaqësohen shtete të mëdha e të vogla, me tradita, përvoja dhe kapacitete të ndryshme ushtarake, është një tregues domethënës i nivelit profesional dhe i autoritetit që ke ndërtuar gjatë karrierës.

Lexova me vëmendje edhe fjalën e ambasadores franceze në ceremoninë e dekorimit. Si shqiptar, ndjeva krenari. Ishte një lajm i mirë jo vetëm për Forcat e Armatosura dhe institucionet e mbrojtjes, por edhe për të gjithë ne që kemi ndarë me Zaimin përvojën, miqësinë dhe një pjesë të rrugëtimit në aviacionin ushtarak.

Për këtë arsye, vendosa të interesohem më tej për motivet dhe vlerësimet që qëndrojnë pas kësaj dekorate. Informacionet që mora më shtynë edhe më shumë të shkruaj për të. Mësova se kolonel Kuçi, shumë kohë përpara publikimit të një dokumenti strategjik francez, kishte analizuar dhe përcjellë në shtyp qëndrimet dhe komentet e tij mbi drejtimet e këtij dokumenti. Një kontribut i tillë dëshmon se angazhimi i tij nuk ishte kufizuar vetëm në detyrat e përfaqësimit diplomatik, por përfshinte edhe analizën, interpretimin dhe komunikimin publik të çështjeve të sigurisë dhe mbrojtjes.

Një tjetër fakt që më bëri përshtypje lidhet me revistën prestigjioze "Mbrojtja" të Institutit të Studimeve të Larta Strategjike të Bashkimit Evropian. Në dy numra të saj, gjatë viteve 2010–2011, Presidenti i Asamblesë Evropiane, z. Colin Cameron, ka shprehur falënderime për kolonel Kuçin. Ky është një vlerësim që e vendos emrin e një oficeri shqiptar në një kontekst të rëndësishëm të bashkëpunimit dhe komunikimit strategjik evropian.



Natyrshëm lind pyetja: sa vëmendje iu kushtua këtyre vlerësimeve nga institucionet tona të mbrojtjes dhe nga shtypi shqiptar? Sa u njoh opinioni publik me një kontribut të tillë?

Mendoj se shoqëria shqiptare duhet të njihet më shumë me njerëzit që kanë lënë gjurmë në shërbim të vendit, veçanërisht kur përvoja dhe puna e tyre janë vlerësuar edhe përtej kufijve. Ne kemi nevojë për modele profesionale, për shembuj përkushtimi dhe për histori që dëshmojnë se përfaqësimi i Shqipërisë mund të jetë dinjitoz në çdo institucion ndërkombëtar.

Një formim profesional në disa nivele

Rrugëtimi i kolonel Zaim Kuçit është ndërtuar mbi një formim të gjerë ushtarak, akademik dhe strategjik, duke nisur nga aviacioni dhe duke vijuar në fushën e planifikimit të mbrojtjes dhe diplomacisë ushtarake.

Arsimimi i tij profesional përfshin:

- Shkollën e Mesme Ushtarake "Skënderbej", Tiranë;
- Akademinë e Aviacionit, Vlorë;
- Akademinë e Mbrojtjes, Tiranë;



- Akademinë Diplomatike Shqiptare, Tiranë.

Formimi i tij është plotësuar edhe me studime jashtë vendit, ndër të cilat veçohen:

- Studimet Ushtarake Superiore në Kolegjin e Mbrojtjes, Paris;

- Studimet Aeronautike në Institutin Francez të Sigurisë Ajrore, Paris.

Gjithashtu, ai ka ndjekur kurse afatshkurtra për doktrinën dhe strategjinë në Shtetet e Bashkuara të Amerikës, Holandë, Hungari, Gjermani dhe Kroaci.

Ky formim i shumanshëm i ka dhënë mundësinë të ndërthurë njohuritë praktike të aviacionit me konceptet e planifikimit operacional, strategjisë ushtarake dhe bashkëpunimit ndërkombëtar.

Nga kabina e avionit te institucionet e larta të mbrojtjes

Karriera e Zaim Kuçit në Forcat e Armatosura është e lidhur ngushtë me aviacionin ushtarak shqiptar. Ai e nisi rrugëtimin si pilot gjuajtës-bombardues, duke fluturuar në avionë reaktivë dhe supersonikë në bazat ajrore të Kuçovës, Gjadrit, Rinasit dhe Vlorës. Përvoja në kabinën e avionit, disiplina e fluturimit dhe përgjegjësia e një profesioni që kërkon përgatitje të vazhdueshme përbëjnë një nga dimensionet më të rëndësishme të formimit të tij. Më pas, karriera e tij u zhvillua edhe në funksione drejtuese, akademike dhe shtabore.

Ndër detyrat më të rëndësishme përmenden:

- Shef i Stërvitjes Fluturuese dhe Shef i Shtabit të Bazës Ajrore Kuçovë;

- Zëvendëskomandant i Akademisë Ajrore, Vlorë;

- Pedagog në Akademinë e Mbrojtjes, Tiranë;

- Shef i Sektorit të Strategjisë në Shtabin e Përgjithshëm të Forcave të Armatosura, pranë Ministrisë së Mbrojtjes;

- Këshilltar i ministrit të Mbrojtjes dhe i shefit të Shtabit të Përgjithshëm të Forcave të Armatosura, duke shërbyer si këshilltar i tre shefave të Shtabit të Përgjithshëm;

- Këshilltar ushtarak dhe këshilltar i Presidentit të Republikës.

Këto detyra pasqyrojnë një karrierë që ka kaluar në disa nivele të përgjegjësisë ushtarake, nga shërbimi operacional në aviacion deri te planifikimi strategjik dhe këshillimi në nivelet më të larta të institucioneve shtetërore.

Një mision diplomatik me dimension të veçantë

Një kapitull i rëndësishëm në karrierën e kolonel Kuçit është shërbimi diplomatik ushtarak. Ai është ndër diplomatët e parë ushtarakë shqiptarë që ka hapur dhe zhvilluar misione përfaqësimi në fushën e sigurisë dhe mbrojtjes në dy vende të rëndësishme të Bashkimit Evropian: Francë dhe Portugali, me qendrat diplomatike në Paris dhe Lisbonë.

Ky mision kërkonte jo vetëm përfaqësim zyrtar, por edhe aftësi për të ndërtuar marrëdhënie, për të promovuar interesat e Shqipërisë dhe për të krijuar ura bashkëpunimi me institucionet ushtarake e strategjike të vendeve pritëse.

Gjatë shërbimit në Paris, Kuçi ndërmori një nismë të veçantë lobimi, të cilën e përmblidhte me moton: **“Shqipëria drejt rrugës në NATO/BE”.**

Përmes kësaj nisme synonte të përcillte në qarqet franceze dhe evropiane zhvillimet, aspiratat dhe angazhimet e Shqipërisë në proceset e integrimit euroatlantik. Ai nuk e shihte diplomacinë ushtarake vetëm si një detyrë protokollare, por si një mundësi për të komunikuar, argumentuar dhe promovuar interesat kombëtare. Në këtë drejtim, angazhimi i tij mori edhe një dimension tjetër: atë të komunikimit publik dhe të bashkëpunimit me median.

Media, një aleat në shërbim të diplomacisë

Kur e pyeta për angazhimin e tij në media, Zaim Kuçi m’u përgjigj duke iu referuar një thënieje të Xhorxh Bajronit, e cila, sipas tij, i kishte mbetur veçanërisht në mendje**: “Një pikë bojë mjafton për të zgjuar mendime për miliona njerëz”**.

Kjo thënie përmbledh edhe filozofinë që ai ndoqi gjatë misionit të tij diplomatik. Kuçi kuptoi se një pjesë e rëndësishme e kontributit të tij mund të përcillej përmes shtypit, duke e konsideruar median një aleat të rëndësishëm për informimin dhe lobimin në interes të Shqipërisë.

“E mendova që kontributi më mirë kalon apo ka efekt nëpërmjet shtypit, duke e zgjedhur atë si një aleat të mirë për lobing në interes të misionit diplomatik që pata në Paris/Lisbonë”, shprehet ai.

Sipas tij, realiteti shqiptar kishte nevojë edhe për këtë punë të vështirë me median, për të sensibilizuar shoqërinë dhe për të rritur njohjen mbi çështjet e sigurisë, mbrojtjes dhe përfaqësimit ndërkombëtar.

“E kam bërë dhe do të vijoj ta bëj, sepse kam bindjen se kjo duhet bërë”, është mesazhi i tij.

Gjatë viteve të angazhimit në këtë fushë, kolonel Kuçi ka botuar më shumë se 50 artikuj në shtypin shqiptar, francez dhe atë evropian, përfshirë revistën **“Defense”**. Shkrimet e tij trajtojnë analiza mbi sigurinë dhe mbrojtjen, çështje strategjike, zhvillimet e marrëdhënieve ndërkombëtare, si dhe opinione në interes të shoqërisë.

Ndër mediat shqiptare ku janë botuar shkrimet e tij përmenden gazetat “Shekulli”, “Dielli/The Sun”, “Telegraf”, “Panorama”, “Shqip”, “SOT” dhe të tjera.

Një vend të veçantë në këtë angazhim zënë edhe botimet në shtypin ushtarak shqiptar, veçanërisht në revistën “Mbrojtja” dhe gazetën “Ushtria”, ku ai ka trajtuar tema që lidhen drejtpërdrejt me zhvillimin e mendimit ushtarak, sigurinë dhe strategjinë e mbrojtjes.

Njohje dhe bashkëpunim në institucionet strategjike evropiane

Gjatë qëndrimit në Francë, kolonel Kuçi është angazhuar në konferenca, simpoziume dhe debate pranë Institutit të Studimeve të Larta për Mbrojtjen Kombëtare të Francës (IHEDN), duke marrë pjesë edhe si folës në aktivitete të ndryshme. Që prej vitit 2008, ai është përzgjedhur nga ky institucion për të përfaqësuar vendin tonë në aktivitete dhe botime të tij. Kjo pjesëmarrje ka rëndësi të veçantë, sepse institucionet strategjike evropiane përbëjnë mjedise ku diskutohen sfidat e sigurisë, zhvillimet gjeopolitike, politikat e mbrojtjes dhe e ardhmja e bashkëpunimit ndërkombëtar. Përzgjedhja e një përfaqësuesi shqiptar në këto veprimtari nuk është vetëm një vlerësim individual. Ajo krijon mundësi që edhe këndvështrimi shqiptar të jetë pjesë e diskutimeve dhe analizave për çështje që prekin sigurinë e përbashkët evropiane.

Këtu qëndron edhe një nga arsyet pse kontributi i Zaim Kuçit meriton të njihet më gjerësisht. Ai ka synuar që Shqipëria të mos jetë vetëm pjesëmarrëse në tryezat ndërkombëtare, por edhe një zë që kontribuon me ide, analiza dhe qëndrime profesionale.

Një karrierë që meriton të njihet

Duke parë këtë rrugëtim, nga piloti gjuajtës-bombardues te pedagogu, nga specialisti i strategjisë te këshilltari i institucioneve të larta dhe diplomati ushtarak, kuptohet se karriera e kolonel Zaim Kuçit përfaqëson një përvojë të gjerë profesionale.

Medalja franceze **“Oficer i Urdhrit Kombëtar të Meritës”** është një moment i rëndësishëm në këtë rrugëtim, por nuk duhet parë e shkëputur nga puna dhe kontributi shumëvjeçar që e paraprin.

Për mua, si bashkëkohës dhe shok i tij në aviacion, ky vlerësim merr edhe një domethënie njerëzore. Ai më kthen te vitet e shërbimit, te sakrificat dhe përgjegjësitë e profesionit të pilotit, por edhe te bindja se përkushtimi ndaj vendit mund të marrë forma të ndryshme gjatë gjithë jetës profesionale.

Prandaj, ky shkrim nuk është vetëm një përshëndetje për një mik dhe koleg të vlerësuar. Është edhe një përpjekje për të sjellë në vëmendjen e publikut një profil që ndërthur përgatitjen ushtarake, përvojën diplomatike, mendimin strategjik dhe komunikimin publik. Shqipëria ka nevojë t’i njohë më mirë njerëzit që e kanë përfaqësuar me dinjitet në institucionet ndërkombëtare. Ka nevojë që përvojat e tyre të mos mbeten vetëm në kujtesën e kolegëve apo në dokumentet e institucioneve, por të bëhen pjesë e kujtesës sonë publike.

Sepse vlerësimi i një individi, kur lidhet me përfaqësimin dinjitoz të vendit, bëhet edhe një arsye krenarie për të gjithë ne.

GJERGJ KASTRIOTI - SKËNDERBEU, GJENERALLEJTËNANTI I PARË SHQIPTAR

Nga komandant i Lidhjes së Lezhës te drejtuesi i lartë ushtarak i Mbretërisë së Napolit, një vështrim historik mbi gradën gjenerallejtënant dhe figurat që e kanë mbajtur atë në Shqipëri dhe Kosovë



PROF. ASOC. DR. ZAHO GOLEMI



Historia ushtarake shqiptare ka një traditë të hershme, e cila lidhet ngushtë me emra, ngjarje dhe figura që kanë kapërcyer kufijtë e vendit, duke fituar vlerësim edhe në historinë ushtarake europiane. Në këtë traditë, Gjergj Kastrioti - Skënderbeu zë një vend të veçantë. Ai nuk ishte vetëm prijësi që bashkoi princat shqiptarë dhe organizoi qëndresën kundër Perandorisë Osmane, por edhe një komandant me autoritet ndërkombëtar, i cili u përfshi në zhvillimet politike dhe ushtarake të Europës së shekullit XV.

Pikërisht në këtë këndvështrim merr rëndësi çështja e titujve dhe funksioneve të larta ushtarake që mbajti Skënderbeu, veçanërisht emërimi i tij, më 18 janar 1461, me titullin "Gjenerallejtënant i mbretit të Puljes", nga mbreti Ferdinand I i Napolit. Ky emërim përbën një dëshmi domethënëse të autoritetit të fituar nga komandanti arbëror dhe të vlerësimit që i bëhej për aftësitë e tij në drejtimin e operacioneve ushtarake.

Përpara se të ndalemi te ky emërim historik, është e nevojshme të kujtojmë se Skënderbeu kishte mbajtur edhe tituj të tjerë të rëndësishëm politikë e ushtarakë. Në ushtrinë osmane arriti titullin "Sanxhakbej", ndërsa në vitin 1444 u zgjodh Kryekomandant i Lidhjes së Lezhës, duke marrë mbi vete përgjegjësinë e drejtimit të bashkimit ushtarak të princërve shqiptarë. Në vitin 1451, mbreti Alfonsi V i Napolit e emëroi Kapiten të Përgjithshëm (Capitano Generale). Më 23 dhjetor 1457, Papa Kalisti III i dha titullin Kapiten i Përgjithshëm i Kurisë Papnore dhe epitetin e njohur "Athleta Christi" – Mbrojtësi i Krishtit.

Skënderbeu ishte njëkohësisht Zot i Arbërisë dhe Princ i Epirit. Këto tituj dëshmojnë se autoriteti i tij nuk kufizohej vetëm në fushën e betejës. Ai ishte udhëheqës politik, organizator i qëndresës kombëtare dhe komandant i aftë për të ndërtuar aleanca me fuqitë e kohës.

Emërimi i vitit 1461, një vlerësim i lartë për komandantin arbëror

Ekspedita ushtarake e Gjergj Kastriotit - Skënderbeut në Italinë e Jugut, gjatë viteve 1460–1462, përbën një nga momentet më të rëndësishme të veprimtarisë së tij ushtarake jashtë Arbërisë. Në atë periudhë, mbreti Ferdinand I i Napolit, i njohur edhe si Ferrante, po përballej me një konflikt të ashpër për ruajtjen e fronit të tij kundër kundërshtarëve anzhuinë, të mbështetur nga forcat franceze.

Në këto rrethana, ndërhyrja e Skënderbeut ishte me rëndësi të veçantë. Në shtator të vitit 1460, ai dërgoi në Itali pararojën shqiptare, të përbërë nga rreth 500 luftëtarë. Në gusht të vitit 1461, u nis vetë në krye të një ushtrie arbërore dhe më 25 gusht zbarkoi pranë Barletës.

Ndërhyrja shqiptare u bë vendimtare për mbështetjen e mbretit Ferdinand, i cili ndodhej në një situatë tepër të vështirë ushtarake. Skënderbeu përdori përvojën e tij të gjatë në luftërat kundër osmanëve, duke ndërthurur manovrat e shpejta, sulmet e befasishme dhe taktikat e luftimit në terrene të ndryshme. Aftësitë e tij komanduese u dëshmuan edhe në përballjet me forcat e Princit të Tarantos, si dhe në operacionet për marrjen e qytetit të Tranit.

Sipas të dhënave të përcjella nga Virgjil Kule, më 18 janar 1461, Ferdinandi e kishte emëruar Skënderbeun "Gjenerallejtënant të mbretit të Puljes". Në praktikë, ky titull nënkuptonte një autoritet të gjerë për të vepruar në fushën ushtarake në emër të mbretit. Ai përfaqësonte një vlerësim të jashtëzakonshëm të aftësive të komandantit shqiptar dhe të besimit që kishte fituar në oborrin mbretëror napolitan.

Siç shprehet Virgjil Kule në veprën "Gjergj Kastrioti - Skënderbeu, Kryqtari i fundit", ky emërim lidhej edhe me aftësinë e Skënderbeut për të ndërthurur metodat e luftës perëndimore me taktikat, dredhitë dhe grackat që kishte përdorur me sukses kundër ushtrisë osmane. Në këtë kuptim, përvoja e tij ushtarake përbënte një pasuri të çmuar edhe për ushtritë e Perëndimit.

Duhet theksuar se emërtimet dhe gradat ushtarake të shekullit XV nuk mund të barazohen në mënyrë të drejtpërdrejtë me sistemin bashkëkohor të gradave. Megjithatë, titulli i dokumentuar në këtë periudhë dëshmon pozitën e lartë komanduese që Skënderbeu kishte fituar në Mbretërinë e Napolit. Për këtë arsye, ai mund të konsiderohet si një nga pararendësit historikë të traditës shqiptare të drejtimit në nivelet më të larta ushtarake.

Marin Barleti, biografi i parë i Skënderbeut, përshkruan gjerësisht autoritetin e tij ushtarak, ekspeditën italiane dhe marrëdhëniet me mbretërit e Napolit, por nuk e dokumenton shprehimisht emërimin me këtë titull. Për këtë arsye, kërkimi në dokumentacionin origjinal italian dhe në arkivat përkatëse mbetet i rëndësishëm për të plotësuar më tej këtë çështje historike.

Skënderbeu u largua nga Italia në fillim të janarit 1462 dhe në shkurt mbërriti në Arbëri, ku e prisnin sfida të reja ushtarake. Beteja e Orsarës, e zhvilluar më 18 gusht 1462, përfundoi me fitoren e forcave të Ferdinandit, por komandanti shqiptar nuk mori pjesë në të, pasi ishte kthyer më parë në atdhe.

Ekspedita italiane dëshmoi se Skënderbeu nuk ishte vetëm mbrojtës i Arbërisë, por edhe një strateg me ndikim në konfliktet ushtarake europiane. Emërimi i tij si gjenerallejtënant i mbretit të Puljes përbën një kapitull me interes të veçantë në historinë e marrëdhënieve shqiptaro-italiane dhe në historinë e mendimit e të drejtimit ushtarak shqiptar.

Gjenerallejtënanti në hierarkinë ushtarake bashkëkohore

Nga titujt dhe funksionet ushtarake të Skënderbeut, vështrimi historik na çon te grada gjenerallejtënant, ashtu siç njihet dhe zbatohet në Forcat e Armatosura bashkëkohore.

Në sistemin e gradave të Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë, gjenerallejtënanti përfaqëson një nga gradat më të larta të hierarkisë së oficerëve madhorë. Në Forcën Tokësore dhe Forcën Ajrore, ajo renditet mbi gradën gjeneralmajor dhe nën gradën gjeneral, sipas hierarkisë përkatëse. Në Forcën Detare, grada përkatëse është admirali.

Në klasifikimin e NATO-s, gjenerallejtënanti përkon me nivelin OF-8, një nga nivelet më të larta të hierarkisë së oficerëve madhorë. Ky klasifikim mundëson krahasimin e gradave të vendeve aleate dhe lehtëson bashkëpunimin në strukturat e përbashkëta ushtarake.

Vetë emërtimi "gjenerallejtënant" ka një histori të gjatë në traditën ushtarake europiane. Termi lidhet me konceptin e drejtuesit që ushtron autoritetin në emër të gjeneralit ose komandantit më të lartë. Me zhvillimin e ushtrive të organizuara, krijimin e shtabeve të përhershme dhe profesionalizimin e strukturave ushtarake, kjo pozitë u shndërrua gradualisht në një gradë të përcaktuar qartë në hierarkinë e komandimit.

Në ushtritë moderne, një gjenerallejtënant mund të drejtojë komanda të mëdha operative, të shërbejë në strukturat e larta të shtabit, të ushtrojë funksione të rëndësishme në drejtimin e mbrojtjes ose të përfaqësojë vendin në komandat dhe institucionet ushtarake shumëkombëshe. Përgjegjësitë e kësaj shkalle janë të gjera. Ato përfshijnë planëzimin e mbrojtjes, vlerësimin e gatishmërisë operacionale, drejtimin e strukturave ushtarake, zhvillimin e kapaciteteve, administrimin e burimeve njerëzore dhe materiale, si dhe bashkërendimin e komponentëve tokësorë, detarë, ajrorë dhe mbështetës.

Në strukturat e NATO-s, oficerët e këtij niveli marrin pjesë në procese të rëndësishme të planëzimit strategjik, në drejtimin e operacioneve të përbashkëta dhe në vendimmarrjen ushtarake të Aleancës. Grada nuk duhet ngatërruar me funksionin. Ajo përcakton pozicionin hierarkik të oficerit, ndërsa funksioni përcakton detyrat dhe përgjegjësitë konkrete që ai ushtron. Përparimi në këtë gradë nuk është rezultat automatik i viteve të shërbimit. Ai lidhet me përvojën në komandim dhe shtab, arsimimin e avancuar ushtarak, kualifikimin profesional, integritetin, vlerësimin e performancës dhe plotësimin e kërkesave ligjore e institucionale.

Në Shqipëri, zhvillimi i sistemit të gradave ka kaluar nëpër periudha të ndryshme historike. Pas krijimit të shtetit shqiptar dhe të strukturave të para të organizuara ushtarake, hierarkia e drejtimit pësoi ndryshime të vazhdueshme, në përputhje me modelet dhe zhvillimet e kohës. Pas Luftës së Dytë Botërore, organizimi ushtarak u ndikua nga modelet jugosllave dhe sovjetike. Më 1 maj 1966, sistemi i gradave ushtarake u hoq dhe organizimi i personelit u mbështet kryesisht në funksionet dhe detyrat organike. Me ndryshimet politike të fillimit të viteve 1990, sistemi i gradave u rivendos më 28 nëntor 1991 dhe më pas iu nënshtrua përshtatjeve të vazhdueshme, në funksion të standardeve euroatlantike.

Ky proces shënoi një etapë të rëndësishme në modernizimin e Forcave të Armatosura shqiptare. Kalimi drejt një sistemi të krahasueshëm me ushtritë e NATO-s kërkoi jo vetëm ndryshime në emërtimet e gradave, por edhe rritjen e profesionalizmit, përgjegjësisë dhe standardeve të drejtimit ushtarak.

Dymbëdhjetë gjenerallejtënantët e Forcave të Armatosura shqiptare

Në historikun e Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë, që nga krijimi i tyre më 4 dhjetor 1912 e deri në vitin 2026, sipas përllogaritjes së autorit, rezultojnë 12 ushtarakë që kanë mbajtur gradën gjenerallejtënant.

Ata janë: Beqir Balluku, Petrit Dume, Rahman Parllaku, Muhamet Prodani, Sadik Bekteshi, Arif Hasko, Vaskë Gjino, Mihallq Ziçishti, Ilia Vasho, Pëllumb Qazimi, Luan Hoxha dhe Arben Kingji, i cili aktualisht mban këtë gradë dhe ushtron detyrën e Shefit të Shtabit të Përgjithshëm të Forcave të Armatosura.

Secili prej këtyre emrave lidhet me një periudhë të caktuar të historisë së organizimit dhe drejtimit ushtarak shqiptar. Ata përfaqësojnë etapa të ndryshme të zhvillimit të strukturave të mbrojtjes, të sistemit të komandimit dhe të karrierës së oficerëve madhorë. Historia e tyre është pjesë e historisë institucionale të Forcave të Armatosura, me ndryshimet, sfidat dhe transformimet që kanë shoqëruar shtetin shqiptar gjatë më shumë se një shekulli.

Në këtë rrugëtim, grada gjenerallejtënant nuk përfaqëson thjesht një shenjë dalluese në uniformë. Ajo është shprehje e një përgjegjësie të lartë profesionale dhe institucionale, e cila kërkon përgatitje të thellë, përvojë të konsoliduar dhe aftësi për të drejtuar struktura komplekse në shërbim të sigurisë kombëtare.

Pesë gjenerallejtënantët e Kosovës, pjesë e historisë së përbashkët ushtarake shqiptare

Në këtë panoramë historike nuk mund të lihet jashtë vëmendjes as Kosova, ku ndërtimi i strukturave të sigurisë dhe i Forcës së Sigurisë së Kosovës përfaqëson një kapitull të rëndësishëm të historisë sonë bashkëkohore. Pas luftës çlirimtare dhe transformimit të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës në Trupat e Mbrojtjes së Kosovës, më 19 shtator 1999, nisi një proces i ri i organizimit institucional të kapaciteteve ushtarake dhe të sigurisë. TMK-ja vijoi veprimtarinë deri më 21 janar 2009, kur filloi funksionimin Forca e Sigurisë së Kosovës.

Në historikun e drejtimit të strukturave ushtarake të Kosovës, pesë emra lidhen me mbajtjen e gradës së gjenerallejtënantit dhe me drejtimin e institucioneve përkatëse:

- Gjenerallejtënant Agim Çeku (1999–2006);
- Gjenerallejtënant Sylejman Selimi (2006–2012);
- Gjenerallejtënant Kadri Kastrati (2012–2015);
- Gjenerallejtënant Rrahman Rama (2015–2021);
- Gjenerallejtënant Bashkim Jashari (2021–2026 dhe në vijim), Komandant i FSK-së.

Këto figura janë pjesë e procesit të ndërtimit dhe konsolidimit të institucioneve të mbrojtjes në Kosovë. Veçanërisht, rrugëtimi nga strukturat e TMK-së drejt Forcës së Sigurisë së Kosovës shënon një transformim të rëndësishëm organizativ dhe profesional, i cili ka synuar ndërtimin e një force moderne, të disiplinuar dhe të ndërveprueshme me partnerët ndërkombëtarë. Në këtë kontekst, karriera e gjenerallejtënantëve të Kosovës pasqyron jo vetëm historinë e institucioneve të reja të mbrojtjes, por edhe përpjekjet për të ndërtuar një kulturë të qëndrueshme komandimi, profesionalizmi dhe përgjegjësie shtetërore.

Nga Skënderbeu te gjeneratat e reja të drejtuesve ushtarakë

Kur vendosim përballë njëri-tjetrit Gjergj Kastriotin - Skënderbeun dhe gjenerallejtënantët e periudhës moderne, nuk bëjmë një barazim mekanik të sistemeve të ndryshme të gradave. Mes tyre ekzistojnë dallime të mëdha historike, institucionale dhe organizative. Por ekziston edhe një vijë lidhëse: përgjegjësia e komandimit, aftësia për të drejtuar njerëzit dhe për të marrë vendime në rrethana të vështira, në shërbim të vendit. Skënderbeu e dëshmoi këtë përgjegjësi në shekullin XV, kur bashkoi princërit shqiptarë, organizoi qëndresën dhe fitoi respektin e oborreve europiane. Emërimi i tij me titullin "Gjenerallejtënant i mbretit të Puljes", në vitin 1461, është një tregues i rëndësishëm i pozitës që kishte fituar në historinë ushtarake të kohës.

Sot, në një realitet krejt tjetër, gjenerallejtënantët e Forcave të Armatosura shqiptare dhe të Kosovës përfaqësojnë nivele të larta të drejtimit profesional, të planëzimit dhe të përgjegjësisë institucionale. Ata veprojnë në kuadër të shteteve moderne, të strukturave të standardizuara dhe të bashkëpunimit ndërkombëtar. Historia e kësaj grade, nga tradita e hershme e komandimit deri te strukturat bashkëkohore të mbrojtjes, na kujton se autoriteti ushtarak nuk ndërtohet vetëm mbi hierarkinë. Ai mbështetet mbi dijen, përvojën, karakterin, besimin dhe aftësinë për të marrë përgjegjësi. Nga Skënderbeu, komandanti që fitoi respektin e Europës së shekullit XV, deri te drejtuesit e sotëm të strukturave ushtarake shqiptare e kosovare, vazhdon të mbetet i njëjtë thelbi i misionit: shërbimi ndaj atdheut, mbrojtja e sigurisë dhe përmbushja me përgjegjësi e detyrës ushtarake.

Gjigantët e Teknologjisë përballë sfidës së inteligjencës artificiale: rritje apo flluskë?



Presioni i Investimeve në Inteligjencën Artificiale

Në vitet e fundit, inteligjenca artificiale është shndërruar në një fushë ku kompanitë më të mëdha të teknologjisë po garojnë me shpejtësi marramendëse. *Amazon*, *Microsoft* dhe *Alphabet* kanë vendosur që të investojnë shuma kolosale për të ndërtuar infrastrukturën e nevojshme – qendra të dhënash gjigante, çipa të personalizuar dhe sisteme *cloud* të avancuara. Por ky entuziazëm nuk është pa kosto. Rritja e *yield*-eve të obligacioneve dhe kostot rekord për sigurimin e borxhit, si në rastin e *Meta*-s, tregojnë se financimi i këtyre projekteve po bëhet gjithnjë e më i shtrenjtë. Investitorët nuk janë më të gatshëm të pranojnë shpenzime kapitale pa prova të menjëhershme përfitimi. Paralajmërimet për një flluskë të mundshme në AI, si ato të Ken Griffin nga *Citadel*, e bëjnë edhe më të ndjeshëm tregun ndaj çdo sinjali negativ. Në këtë kontekst, rezultatet e *Big Tech* nuk janë thjesht raportime financiare, por një test i madh për të kuptuar nëse bumi i AI-së është i qëndrueshëm apo spekulativ. Nëse këto investime nuk sjellin kthime të shpejta, mund të shohim një korrigjim të fortë në tregjet globale.

Turbulencat e Tregut Global

Tregjet globale po përballen me pasiguri të mëdha. Në SHBA, një fitore e mundshme e demokratëve në zgjedhjet afatmesme mund të sjellë politika më të ashpra ndaj qendrave të të dhënave, të cilat tashmë janë nën presion për konsumin e energjisë dhe ndikimin mjedisor. Protestat kundër rritjes së faturave të energjisë dhe ndikimit ekologjik të serverëve gjigantë po shtohen. Ndërkohë, në Kinë, bumi i teknologjisë ka rënë ndjeshëm: rreth 480 miliardë dollarë kapitalizim tregu janë fshirë në më pak se katër muaj. Rënia e kërkesës për AI-në dhe kufizimet e eksportit kanë ulur vlerësimet e kompanive teknologjike, duke treguar se entuziazmi i tepruar mund të kthehet shpejt në humbje masive kapitali. Ky është një paralajmërim i qartë për tregjet globale: bumi i AI-së nuk është i garantuar dhe mund të përballet me korrigjime të forta. Nëse Kina, një nga tregjet më të mëdha të teknologjisë, po përjeton një rënie kaq të madhe, atëherë investitorët globalë duhet të jenë të kujdesshëm për të mos rënë në kurthin e mbivlerësimit.

Rezultatet e Pritshme për Big Tech

Rezultatet e *Amazon*, *Microsoft* dhe *Alphabet* pritet të jenë të fuqishme, por me dallime të rëndësishme. *Google Cloud* pritet të raportojë një rritje të jashtëzakonshme prej 95.1%, duke arritur 29.57 miliardë dollarë. Kjo e vendos *Alphabet* në një pozitë të fortë në *cloud*, por biznesi i kërkimit po ngadalësohet, duke u rritur vetëm 14.7% krahasuar me 16.8% më parë. Amazon Web Services pritet të rritet me 38.2%, duke ruajtur pozicionin si lider i tregut, por të ardhurat totale të *Amazon* po ngadalësohen ndjeshëm (nga 19.6% në 12.3%). *Microsoft Azure* pritet të rritet me 47.7%, duke arritur 33.06 miliardë dollarë, ndërsa kompania do të gjenerojë mbi 8 miliardë dollarë, duke e vendosur në një pozitë më të fortë financiare krahasuar me rivalët. Struktura e re e raportimit të Microsoft-it, që kombinon *cloud*, AI dhe softuerin e biznesit në një divizion të vetëm, do të sjellë transparencë mbi të ardhurat absolute të *Azure*, një kërkesë e kahershme e investitorëve. Kjo transparencë është e rëndësishme sepse investitorët duan të shohin jo vetëm përqindjet e rritjes, por edhe shifrat absolute që tregojnë madhësinë reale të biznesit.

Krahasimi me Meta

Meta është një shembull i qartë i dilemës që po përballen kompanitë teknologjike. Pavarësisht se raportoi të ardhura më të mira se pritjet dhe dha një *outlook* pozitiv, planet e shpenzimeve kapitale e dërguan aksionin poshtë me 7%. Investitorët nuk po tolerojnë më rritje të kostove pa prova të menjëhershme përfitimi. Aksionet e saj janë ulur mbi 4% këtë vit, duke treguar se tregu po e ndëshkon mungesën e disiplinës financiare. Ky është një paralajmërim për *Amazon*, *Microsoft* dhe *Alphabet*: rritja e të ardhurave nuk mjafton më, duhet të tregojnë se shpenzimet kapitale po sjellin kthime konkrete. Nëse Meta, një kompani që ka investuar fuqishëm në AI dhe realitetin virtual, po përballet me skepticizëm të tillë, atëherë edhe gjigantët e tjerë duhet të jenë të kujdesshëm për të mos humbur besimin e tregut.

Pikat e Forta dhe Dobësitë e Secilës Kompani

Alphabet ka një aset strategjik në *cloud* dhe çipat e brendshëm, por rreziku që AI-ja të zëvendësojë kërkimin tradicional si burim kryesor të të ardhurave është real. Microsoft është në pozitën më të fortë, falë gjenerimit të fluksit të parasë dhe transparencës së re në raportim. *Amazon* mbetet lider absolut në *cloud* me AWS, por ngadalësimi i të ardhurave totale dhe djegia e parasë *cash* e vendosin në një pozitë më të brishtë. Secila kompani ka avantazhe të mëdha, por edhe dobësi që mund të ndikojnë në perceptimin e investitorëve. *Alphabet* duhet të tregojë se AI-ja nuk do të dëmtojë motorin kryesor të të ardhurave – kërkimin. Microsoft duhet të ruajë ritmin e rritjes dhe të tregojë se mund të balancojë shpenzimet kapitale me gjenerimin e *cash*-it. *Amazon* duhet të tregojë se AWS mund të mbështesë shpenzimet kapitale pa rrezikuar fluksin e parasë.

Implikimet për Investitorët

Rezultatet e këtyre kompanive do të jenë një provë vendimtare për bumin e AI-së. Investitorët kërkojnë jo vetëm rritje të të ardhurave, por edhe prova të qarta të gjenerimit të fluksit të parasë për të justifikuar shpenzimet kapitale. Shembulli i Kinës tregon se mbivlerësimi mund të kthehet në humbje masive kapitali. Nëse *cloud*-i nuk arrin të gjenerojë fitime të mjaftueshme, mund të shohim një korrigjim të fortë në tregjet globale. Për investitorët, kjo është një periudhë ku duhet të jenë të kujdesshëm dhe të analizojnë jo vetëm shifrat e rritjes, por edhe strukturën e kostove dhe aftësinë e kompanive për të gjeneruar *cash*. Nëse këto kompani nuk arrijnë të tregojnë se investimet në AI po sjellin përfitime konkrete, mund të shohim një rënie të besimit në tregun e teknologjisë.

Konkluzione Strategjike të Zgjeruara

Rezultatet e *Amazon*, *Microsoft* dhe *Alphabet* nuk janë thjesht raportime tremujore të zakonshme – ato përfaqësojnë një pikë kthese për ekonominë globale dhe për perceptimin e investitorëve mbi inteligjencën artificiale. Nëse këto kompani arrijnë të tregojnë se investimet kolosale në AI po sjellin përfitime konkrete, atëherë mund të kemi një dekadë të re të rritjes së teknologjisë, të krahasueshme me revolucionin e internetit në vitet '90. Por nëse shifrat tregojnë ngadalësim të rritjes, djegie të *cash*-it dhe mungesë disipline financiare, atëherë mund të përballemi me një flluskë të rrezikshme që do të tronditë jo vetëm tregjet e teknologjisë, por edhe ekonominë globale.

Amazon

Amazon është në një pozitë delikate. AWS mbetet lider absolut në *cloud*, por ngadalësimi i të ardhurave totale dhe djegia e *cash*-it janë sinjale shqetësuese. Kompania duhet të tregojë se AWS mund të mbështesë shpenzimet kapitale pa rrezikuar fluksin e parasë. Nëse nuk arrin ta bëjë këtë, investitorët mund të humbasin besimin dhe aksionet të pësojnë rënie të ndjeshme. *Amazon* ka avantazhin e madh të diversifikimit – nga e-commerce tek logjistika – por në këtë moment, *cloud* është linja që do të përcaktojë perceptimin e tregut.

Microsoft

Microsoft është në pozitën më të fortë krahasuar me rivalët. Gjenerimi i mbi 8 miliardë dollarëve e vendos në një pozitë të qëndrueshme financiare. Struktura e re e raportimit, që kombinon *cloud*, AI-në dhe softuerin e biznesit në një divizion të vetëm, do të sjellë transparencë mbi të ardhurat absolute të *Azure*. Kjo transparencë është e rëndësishme sepse investitorët duan të shohin jo vetëm përqindjet e rritjes, por edhe shifrat absolute që tregojnë madhësinë reale të biznesit. Microsoft ka avantazhin e madh të integrimit të AI-së në produktet ekzistuese si *Office* dhe *Teams*, duke krijuar një ekosistem ku AI nuk është thjesht një shtesë, por një pjesë organike e platformës. Nëse Microsoft arrin të tregojë se AI-ja po sjell përfitime konkrete në produktivitet dhe fluksin e parasë, atëherë mund të konsolidojë pozicionin si lider i padiskutueshëm në këtë fushë.

Alphabet (Google)

Alphabet ka një aset strategjik në *cloud* dhe çipat e brendshëm, por rreziku që AI-ja të zëvendësojë kërkimin tradicional si burim kryesor të të ardhurave është real. *Google Search* ka qenë për dekada motori kryesor i fitimeve të kompanisë, por me shfaqjen e agjentëve personalë të AI-së dhe *chatbot*-eve si ChatGPT, ky model po vihet në pikëpyetje. Nëse përdoruesit fillojnë të kërkojnë informacion përmes agjentëve të AI-së dhe jo përmes kërkimit tradicional, atëherë *Alphabet* mund të përballet me një sfidë ekzistenciale. Megjithatë, rritja e jashtëzakonshme e *Google Cloud* tregon se kompania po arrin të diversifikojë të ardhurat dhe të krijojë një burim të ri fitimi. Sfida e madhe për *Alphabet* është të balancojë suksesin e *cloud*-it me sfidat në kërkim, duke treguar se AI-ja nuk do të dëmtojë motorin kryesor të të ardhurave.

Meta si Paralajmërim

Meta është një paralajmërim i qartë për të gjitha kompanitë teknologjike. Pavarësisht se raportoi të ardhura më të mira se pritjet dhe dha një parashikim pozitiv, planet e shpenzimeve kapitale e dërguan aksionin poshtë me 7%. Investitorët nuk po tolerojnë më rritje të kostove pa prova të menjëhershme përfitimi. Aksionet e saj janë ulur mbi 4% këtë vit, duke treguar se tregu po e ndëshkon mungesën e disiplinës financiare. Ky është një mesazh i qartë për *Amazon*, *Microsoft* dhe *Alphabet*: rritja e të ardhurave nuk mjafton më, duhet të tregojnë se shpenzimet kapitale po sjellin kthime konkrete. Nëse nuk arrijnë ta bëjnë këtë, mund të përballen me të njëjtin fat si Meta.

Perspektiva Globale dhe Rreziku i Flluskës

Rezultatet e *Big Tech* nuk janë thjesht shifra korporatash – ato janë tregues të ekonomisë globale. Nëse AI-ja arrin të justifikojë shpenzimet kapitale, mund të jetë motori i rritjes së dekadës së ardhshme. Por nëse jo, mund të përballemi me një flluskë të rrezikshme që do të tronditë tregjet botërore. Shembulli i Kinës është një paralajmërim i qartë: mbivlerësimi mund të kthehet shpejt në humbje masive kapitali. Nëse një treg kaq i madh si Kina po përjeton një rënie kaq të madhe, atëherë investitorët globalë duhet të jenë të kujdesshëm për të mos rënë në kurthin e entuziazmit të tepruar.

Mesazh për Lexuesit Shqiptarë

Për lexuesit shqiptarë, kjo analizë ka një rëndësi të veçantë. Edhe pse Shqipëria nuk është një treg i madh teknologjik, rezultatet e *Big Tech* ndikojnë drejtpërdrejt në ekonominë globale dhe, rrjedhimisht, edhe në ekonominë tonë. Nëse AI-ja arrin të justifikojë shpenzimet kapitale, mund të shohim një rritje të madhe të investimeve në teknologji, që do të sjellë përfitime edhe për tregjet më të vogla. Por nëse bumi i AI-së kthehet në një flluskë, atëherë mund të përballemi me një krizë globale që do të ndikojë edhe tek ne.



“Sa kohë valëvitet flamuri kuqezi, do të ketë burra e gra në uniformë që do të qëndrojnë në shërbim të tij. Sepse Shqipëria është më shumë se një tokë: është betim, identitet dhe përgjegjësi!”